



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 23

Tiranë – E martë, 26 shkurt 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 11084, datë 21.2.2019	Për një ndryshim në dekretin nr. 11065, datë 24.1.2019, “Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare”..... 767
Dekret i Presidentit nr. 11104, datë 22.2.2019	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 767
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 3, datë 21.2.2019	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 19, datë 3.11.2014, për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar të ndryshuar..... 767
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 4, datë 22.2.2019	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar..... 768
Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 5, datë 21.2.2019	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 776
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 16, datë 18.2.2019	Mbi shtyrjen e afatit të zbatimit të kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal për periudhën 1.1.2018–31.12.2018 dhe kontratës për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezultojnë pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018”..... 783
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 17, datë 18.2.2019	Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike..... 785

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 18, datë 18.2.2019	Mbi fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.....	786
Vendim i Entit Rregullator të energjisë nr. 19, datë 18.2.2019	Mbi fillimin e procedurës për miratimin e disa shtesave në “Rregullat e përkohshme të mekanizmit balancues”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017.....	787
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 20, datë 18.2.2019	Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 245, datë 26.11.2018, “Për licencimin e shoqërisë ‘Renrgy Trading Group’” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.....	788
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 21, datë 18.2.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.	789
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 22, datë 18.2.2019	Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike...	790
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 23, datë 18.2.2019	Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin janar 2019.....	791
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 4, datë 1.2.2019	Për një ndryshim në vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 30, datë 18.07.2017, “Për licencimin e sha ujësjellës-kanalizime Berat–Kuçovë”, i ndryshuar.....	792
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 5, datë 1.2.2019	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë ujësjellës-kanalizime Vorë.....	793
Vendim i Entit Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura nr. 6, datë 1.2.2019	Për fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura për shoqërinë ujësjellës-kanalizime Tropojë.....	794

**DEKRET****Nr. 11084, datë 21.2.2019**

**PËR NJË NDRYSHIM NË DEKRETIN
NR. 11065, DATË 24.1.2019, “PËR LEJIMIN
E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE”**

Në mbështetje të nenit 93 të Kushtetutës së Shqipërisë,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Ndryshimin e pikës 21 të nenit 1 të dekretit nr. 11065, datë 24.1.2019, “Për lejim të lënies së shtetësisë shqiptare”, nga “Entela Edmond Schwiemann (Hasani)” në “Entela Hysen Schwiemann (Hasani)”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Ilir Meta

DEKRET**Nr. 11104, datë 22.2.2019**

**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË
SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe nenit 93, të Kushtetutës, si dhe nenit 9 e nenit 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar, me propozim edhe të Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U jepet shtetësia shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Merve Abdülaziz Aksoy
2. Ebru Ömer Faruk Aksoy (Keklik)
3. Yifet Ragip Aksoy
4. Kahraman Abdülmennan Aksoy
5. Faton Halit Bislimi
6. Driton Qerim Gashi
7. Afërdita Daut Gashi (Berisha)
8. Ercan Erol Er
9. Njazi Sadri Thaçi
10. Teuta Gani Thaçi (Shala)
11. Albrim Njazi Thaçi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

UDHËZIM**Nr. 3, datë 21.2.2019**

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 19, DATË 3.11.2014,
PËR ZBATIMIN E REGJIMIT TË
VEÇANTË TË SKEMËS SË
KOMPENSIMIT TË PRODHUESVE
BUJQËSORË PËR QËLLIME TË TATIMIT
MBI VLERËN E SHTUAR TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 19, datë 3.11.2014 “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në nenin 8 “Mënyra e zbatimit të skemës së kompensimit”, pika 2, togfjalëshat: “...përfshirë normën e kompensimit e cila është 20%” dhe “TVSH-ja e shënuar në faturë prej 20%...”, bëhen “... përfshirë normën e kompensimit e cila është 6%”, dhe “TVSH-ja e shënuar në faturë prej 6% ...”.

2. Në nenin 9 “E drejta e zbritjes së TVSH-së së kompensuar”, pika 3, togfjalëshi: “Personi i tatueshëm blerës nuk ka të drejtë të kreditojë kompensimin prej 20% ...”, bëhet “Personi i tatueshëm blerës nuk ka të drejtë të kreditojë kompensimin prej 6% ...”.

3. Në nenin 11 “Deklarimi” bëhen këto ndryshime:

3.1 Në pikën 1, togfjalëshi “... produkt i vlerës së tatueshme të mallit me përqindjen e kompensimit, e cila sipas këtij ligji është 20%”, bëhet “... produkt i vlerës së tatueshme të mallit me përqindjen e kompensimit, e cila sipas këtij ligji është 6%”.



3.2 Në pikën 2, togfjalëshi “Për qëllime të llogaritjes së normës së kompensimit në masën 20%, ...”, bëhet: “Për qëllime të llogaritjes së normës së kompensimit në masën 6%, ...

3.3 Shembulli i dhënë në pikën “2”, zëvendësohet me shembullin si më poshtë:

Shembull

Një fermer, i identifikuar si individ “A.B.”, i cili ushtron veprimtari si prodhues bujqësor në vreshtari dhe kultivon e prodhon rrush, ja shet këtë produkt shoqërisë “X”, e cila prodhon verë dhe është e regjistruar si person i tatueshëm për TVSH-në. Fermeri “A.B.” i shet shoqërisë “X” rrushin për një vlerë 30.000 lekë ku përfshihen të gjitha kostot e prodhimit, puna e gjallë dhe fitimi i fermerit. Shoqëria X i detyrohet fermerit A.B. për vlerën e furnizimit 30.000 lekë, plus normën e kompensimit 6 % ose 1.800 lekë. Pra, shuma gjithsej që shoqëria “X” do i paguajë fermerit “A.B.”, është $30.000 + 1.800 = 31.800$ lekë.

Detyrimet e fermerit

Fermeri A.B. për të përfituar nga skema e kompensimit duhet të regjistrohet në drejtorinë rajonale tatimore për t’u pajisur me NIPT brenda dy ditësh pune. Drejtoria rajonale tatimore pajis me certifikatë NIPT-i fermerin, duke shënuar si emër “Fermeri A.B.” dhe NIPT-in që gjeneron sistemi.

Detyrimet e personit të tatueshëm

Shoqëria “X”, përpunues rrushi që merr furnizimin, përpara se të lëshojë faturën e parë në emër të fermerit, duhet të njoftojë drejtorinë rajonale tatimore përkatëse që është aplikues i skemës së kompensimit të fermerit duke i bashkëngjitur dhe marrëveshjen me fermerin.

Personi i tatueshëm “X”, në momentin që ka marrë furnizimin prej fermerit, përpilon faturën tatimore të shitjes me TVSH. Në të dhënat identifikuese personi përgjegjës i blerësit (shoqërisë “X”) që plotëson faturën, në të dhënat e shitësit shënon emrin e fermerit sipas regjistrimit përkatës “Fermeri A.B.”; NIPT: L.....N dhe të gjitha të dhënat e kërkuara sipas formatit të faturës.

Lidhur me furnizimin, në rubrikën përkatëse të faturës shënohen përkatësisht të dhënat e kërkuara mbi përshkrimin e mallit, njësinë, sasinë, çmimin për njësi etj.

Sipas shembullit të marrë ku vlera gjithsej e furnizimit është 31.800 lekë, pra kjo është shuma që blerësi person i tatueshëm do t’i paguajë shitësit fermer, në faturë, në vlerën e tatueshme do të

shënohet vlera 30.000 lekë që përfaqëson vlerën e shitjes nga fermeri, ndërsa në kutinë e TVSH-së do të llogaritet nga shoqëria “X” norma e kompensimit 6 % e kësaj vlere të tatueshme, pra $30.000 \text{ lekë} \times 6\% = 1.800 \text{ lekë}$, dhe vlera totale e furnizimit do jetë 31.800 lekë. Pra pavarësisht se vlera e furnizimit nga fermeri është 30.000 lekë (kostot dhe fitimi i tij), ai paguhet nga shoqëria “X” edhe me +6% mbi këtë vlerë, e cila përfaqëson normën e kompensimit për fermerin, shumë të cilën shoqëria “X” e merr përsëri nga TVSH-ja që llogarit për shitjen e verës si person i tatueshëm që është, nëpërmjet mekanizmit të kreditimit të TVSH-së.

Në faturë duhet të shkruhet dukshëm “Vetëfaturim i TVSH-së sipas regjimit për kompensim të fermerit”. Nëse fatura nuk ka këtë shënim, personit të tatueshëm X nuk i lejohej të zbresë TVSH-në e faturës. Fatura origjinale do të mbahet nga blerësi i produkteve dhe fermerit i jepet kopja e dytë e faturës. Kjo faturë nga personi i tatueshëm blerës regjistrohet në librin e blerjes në rubrikat përkatëse “Blerje nga fermerë”, ilustruar si në librin bashkëngjitur.

MINISTRI I FINANCVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

UDHËZIM

Nr. 4, datë 21.2.2019

PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 5, DATË 30.1.2006 “PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në zbatim të nenit 40 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, ministri i Financave,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 5, datë 30.1.2006 “Për Tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

Në pikën 1.4 “Burimi i të ardhurave”, pas nënpikës 1.4.2 shtohen nënpikat 1.4.3 dhe 1.4.4 me këtë përmbajtje:

1.4.3 Paragrafi “dh”, i nenit 4 të ligjit sqaron se të ardhurat që rrjedhin nga të drejtat për



shfrytëzimin e resurseve dhe të mirave natyrore shqiptare, konsiderohen me burim në Shqipëri, janë të tatueshme në Shqipëri dhe do të trajtohen në të njëjtën mënyrë si të ardhurat e tjera nga pasuria e paluajtshme. Këto të drejta në veçanti përfshijnë licencat dhe marrëveshjet që lejojnë nxjerrjen e mineraleve, apo të naftës dhe gazit. Gjithashtu, të ardhurat që sigurohen nga informacionet dhe të dhënat që kanë të bëjnë me këto të drejta, janë objekt i parashikimeve të paragrafit “dh”. Shembull: informacioni sizmik, informacione të tjera teknike dhe analiza që mund të disponohen në lidhje me ekzistencën e burimeve natyrore, p.sh., naftës, gazit, kromit etj., informacione të cilat transferohen te palët e treta.

1.4.4 Paragrafi “e” i nenit 4 trajton si të ardhura me burim në Shqipëri, të ardhurat nga tjetërsimi i të drejtave objekt i paragrafit “dh” të nenit 4. Nën-pika “i” e paragrafit “e” mbulon veçanërisht përfitimet nga shitja e drejtpërdrejtë e të drejtave për të shfrytëzuar burimet natyrore, apo informacionit që u përket të drejtave të tilla. Nën-pika “ii” e paragrafit “e” mbulon shitjet indirekte të aksioneve, të drejtave dhe informacionit të mbuluara nga paragrafi “dh”. Ajo bazohet në parimet e nenit 13(4) të Modelit të tatimit mbi të ardhurat të Konventave të OECD-së dhe OKB-së. Fitimet nga shitja e aksioneve (ose interesave të ngjashëm) që rrjedhin nga pasuria, të drejtat ose informacionet e përmendura në paragrafin “dh” trajtohen si me burim në Shqipëri. Megjithatë, duhet që këtyre aksioneve të paktën 50 për qind e vlerës së tyre t’iu burojnë nga pasuria, të drejtat ose informacioni në fjalë. Këto parashikime janë të rëndësishme kryesisht për shit/blerjet e aksioneve ndërmjet personave jorezidentë shqiptarë, në lidhje me pasuri dhe të drejta të vendosura në Shqipëri, ndërkohë që, rezidentët shqiptarë tatohen për të gjithë të ardhurën në baza mbarëbotërore.

Në pikën 2.3 “Të ardhurat e tatueshme”, bëhen ndryshimet e mëposhtme;

Në nën-pikën 2.3.1/b) te shembulli togfjalëshi “...Dhjetor 2003...”, zëvendësohet me togfjalëshin “...Janar 2019...”

Në nën-pikën 2.3.1/b) pas fjalisë me përmbajtjen “Kjo shumë do të tatohet me tatim në burim”, fjalitë në vijim ndryshohen me këtë përmbajtje:

“Për shpërblimin e marrë nga individ i X nga pjesëmarrja në Komisionin e Testimit të subjektit

“Z”, detyrimi tatimor është 15 për qind, ose 1500 lekë (10.000 x15 %), tatim që mbahet në burim nga subjekti “Z”;

Për të ardhurat e përfituara nga revista e huaj prej 8.000 lekë individ i X duhet të deklarojë në organin përkatës tatimor dhe të derdhë një tatim në masën 15%, pra 1200 lekë”.

Në nën-pikën 2.3.7, pas fjalisë me përmbajtje “Në këtë grup përfshihen të ardhurat...”, ndryshohet fjalia në vijim me këtë përmbajtje:

“Këto të ardhura tatohen sipas përcaktimeve të bëra në udhëzimin e përbashkët nr. 29, datë 30.7.2018 “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme”.

Në pikën 2.4 “Të ardhura të përjashtuara”, në nën-pikën 10 pas fjalisë “Të ardhurat e përfituara nga kalimi i së drejtës së pronësisë...”, shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Përjashtohen, gjithashtu, rastet e kalimit të së drejtës së pronësisë brenda lidhjes gjinore burrë, grua, fëmijë, nëpërmjet dhurimit dhe/ose heqjes dorë nga pasuria, kur pasuria rrjedh nga bashkëpronësia e detyrueshme e fituar në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991, “Për token”, të ndryshuar.”.

Në pikën 2.5 “Tarifat tatimore”, nën-pika 2.5.2 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“2.5.2 Dividentët, të ardhurat që rrjedhin si fitim i ortakut, qoftë ky ortak i vetëm, tatohen me 8 për qind. Interesat nga huat, depozitat ose kontratat e ngjashme, të ardhurat nga e drejta e autorit ose pronësia intelektuale, qiratë apo të ardhura nga kontrata e tjera të ngjashme (huapërdorja, enfitheza), tatohen 15 për qind në përputhje edhe me sqarimet e dhëna në dispozitat e tjera të këtij udhëzimi (pikat 2.3 dhe 5).

Në pikën 2.7 “Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme”, nën-pikat 2.7.1 dhe 2.7.2 ndryshojnë me këtë përmbajtje:

“2.7.1 Me kalim të së drejtës së pronësisë (ndërtesë, truall dhe tokë bujqësore), kuptohet akti i shitjes, dhurimit apo heqjes dorë nga pasuria e paluajtshme. Me termin “fitim kapital i realizuar”, kuptohet diferenca pozitive ndërmjet vlerës në shitje dhe vlerës në blerje të pasurisë së paluajtshme tokë dhe/ose ndërtesë. Në rastin e dhurimit apo heqjes dorë, për efekt të llogaritjes së tatimit, vlera e pasurisë së paluajtshme që dhurohet përcaktohet në bazë të udhëzimit të përbashkët nr. 29, datë 30.7.2018, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së



pronësisë së pasurisë së paluajtshme”. Shkëmbimi i truallit me sipërfaqe ndërtimi, në bazë të një kontrate shkëmbimi, nuk përbën moment për llogaritje të ndonjë fitimi kapital nga transferimi i pasurisë së paluajtshme.”

“2.7.2 Kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme tatóhet siç përcaktohet në udhëzimin e përbashkët nr. 29, datë 30.7.2018, “Për tatimin e kalimit të së drejtës së pronësisë së pasurisë së paluajtshme”.

Në pikën 3.1 “Fush.a., e veprimt të tatimit mbi fitimin”, pas fjalisë me përmbajtjen “Çdo person tjetër, pavarësisht nga forma juridike e regjistrimit të tij...”, shtohet paragrafi me këtë përmbajtje:

“Çdo person jorezident që nuk i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat nga të drejtat mbi pasuritë e paluajtshme, të drejtat mbi to, apo nga tjetërsimi i tyre. Ky person jorezident i nënshtrohet tatimit mbi fitimin që rezulton nga shitja e aksioneve objekt i nenit 4 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Pra, jorezidenti nuk është subjekt i tatimit mbi fitimin nëse ky jorezident është subjekt i tatimit mbi të ardhurat si më sipër. Si rezultat, detyrimi i vetëm për tatimin e jorezidentëve, qoftë për tatimin mbi të ardhurat ose tatimin mbi fitimin, është që burimi i të ardhurave duhet të jetë në Shqipëri, sikurse përcaktohet edhe në nenet 7(2) dhe 17(2) të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Në këtë mënyrë, sigurohet efekt i plotë nga zgjerimi i konceptit të burimit të të ardhurave në Republikën e Shqipërisë”.

Në pikën 3.2 “Detyrimi për të paguar”, bëhen ndryshimet e mëposhtme;

Në shembullin e parë, togfjalëshi “...për vitin 2006...”, zëvendësohet me togfjalëshin “...për vitin 2018...”

Në shembullin e parë, togfjalëshi “...në masën 20% mbi fitimin...”, zëvendësohet me togfjalëshin “...në masën 15% mbi fitimin...”

Në shembullin e dytë, paragrafi që fillon “Fitimet e realizuara përkatësisht...” zëvendësohet me paragrafin me këtë përmbajtje:

Fitimet e realizuara përkatësisht supozojmë se janë:

- Në Itali 40.000.000 lekë

- Në Shqipëri 15.000.000 lekë

Në këtë rast, tatimi mbi fitimin që ky tatimpagues paguan në Shqipëri është 15.000.000 x 15% = 2.250.000 lekë, pasi ai është tatimpagues jorezident dhe paguan tatim mbi fitimin vetëm për fitimet e realizuara në Shqipëri.

Në pikën 3.4 “Fitimi i tatueshëm”, togfjalëshi “...Ligjin nr. 7661, datë 19.1.1993 “Për kontabilitetin...”, zëvendësohet me togfjalëshin “...Ligjin “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare...”

Në pikën 3.6 “Shpenzime të panjohura”, bëhen ndryshimet e mëposhtme

Pas nënpikës “s”, shtohet nënpika “sh”, me këtë përmbajtje;

“sh. shpenzimet për dieta që tejkalojnë 50 përqind të fondit të pagës bruto vjetore.”.

Pas fjalisë “Kur secili prej shpenzimeve...”, shtohet nënpika “t”, me këtë përmbajtje;

“t. Në rastet e kredive, të huamarrjes ose financimeve nga personat e lidhur, nuk njihen si shpenzime të zbritshme të periudhës tatimore teprica e shpenzimit të interesit neto që tejkalon 30 përqind të fitimit të tatueshëm para interesit, tatimit, zhvlerësimit dhe amortizimit (EBITDA). EBITDA përcaktohet në përputhje me nenin 19 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”.

Me termin “Tepriçë të shpenzimit të interesit neto” nënkuptohet teprica që del nga diferenca e shpenzimeve të interesit me të ardhurat nga interesi.

Çdo shpenzim interesi, që nuk zbritet sipas kësaj pike, mbartet në periudhat e ardhshme tatimore, përveç nëse 50 përqind të aksioneve ose të të drejtave të votës në shoqëri janë transferuar.

Përcaktimet e mësipërme nuk zbatohen për bankat, institucionet financiare jobankare të kredihënies, shoqëritë e sigurimeve dhe kompanitë e *leasing-ut*.

Shembull:

Të dhënat financiare për shoqëritë A dhe B jepen në tabelën e mëposhtme:

	Shoqëria A (në lekë)	Shoqëria B (në lekë)
teprica e shpenzimeve neto të interesit	+10 milionë	+40 milionë
= EBITDA	= \100 milionë	=100 milionë
× përqindjen e vendosur	×30%	×30%
= maksimumi i lejuar si shpenzime të zbritshme	=30 milionë	=30 milionë



Shpenzimet neto të interesave të pazbritshme	0	10 milionë
--	---	------------

Shoqëria A është pjesë e një grupi shoqërisht shumëkombëshe. Shoqëria A ka tepricë të shpenzimeve neto të interesit prej 10 milionë lekë dhe EBITDA prej 100 milionë lekë. Kjo tepricë e shpenzimeve neto të interesit rezulton nga interesat e kredive/huamarrjeve/financimeve, që shoqëria A ka me palët e lidhura. Për shkak se shoqëria A ka një raport interesi neto / EBITDA nën 30%, ajo mund të zbresë të gjithë shpenzimet neto të interesit.

Shoqëria B është pjesë e një grupi shoqërisht shumëkombëshe. Shoqëria B ka tepricë të shpenzimeve neto të interesit prej 40 milionë lekë dhe EBITDA prej 100 milionë Lekë. Kjo tepricë e shpenzimeve neto të interesit rezulton nga interesat e kredive / huamarrjeve / financimeve, që shoqëria B ka me palët e lidhura. Për shkak se shoqëria B ka një raport interesi neto/ EBITDA mbi 30%, ajo nuk mund të zbresë të gjithë shpenzimet neto të interesit. Shoqëria B në këtë rast lejohet të zbresë 30 milionë lekë shpenzime neto interesi dhe 10 milionë lekë nuk lejohen të zbriten, por mbarten në periudhat e ardhshme tatimore. Kështu, p.sh nëse periudhën e ardhshme tatimore shpenzimet neto rezultojnë 15 milionë lekë dhe EBITDA prej 100 milionë lekë, shoqëria lejohet të zbresë dhe shpenzimet e mbartura (15+10=25 mil lekë<30 mil lekë, që është vlera e lejuar).

Në rastet e kredive, të huamarrjes ose financimeve nga persona jo të lidhur, zbatohen kufizimet e paragrafit “g” të pikës 3.6.

Në pikën 3.7.2, në fund të paragrafit të tretë pas pikës “d” “Për të gjitha aktivet që hyjnë gjatë periudhës ushtrimore.....” shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

Llogaritja e amortizimit ndërpritet për të gjitha llojet e aktiveve afatgjata që nuk marrin pjesë në veprimtarinë ekonomike të tatimpaguesit, përfshirë mospërdorimin e tyre apo daljen jashtë veprimtarisë.

Në pikën 3.9, pas nënparagrafit “ii”, shtohet nënparagrafi “iii” me këtë përmbajtje;

“iii) në rast se pasuria e luajtshme ose e paluajtshme që siguron kredinë, ekzekutohet para afateve të përcaktuara në shkronjën i) më lart, provizionet e mëparshme bankare, të njohura si shpenzime të zbritshme, do të vazhdojnë të njihen

si të tilla.”

Pas pikës 3.11 “Mbartja e humbjeve”, shtohet pika 3.11/1 “Ndryshimi i pronësisë”, me këtë përmbajtje:

3.11/1 NDRYSHIMI I PRONËSISË

Qëllimi i nenit 27/1 të ligjit është të sigurojë, në masën e mundshme, që fitimet nga shitjet /transferimet indirekte të aseteve të vlefshme, të vendosura në Shqipëri janë subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Një shitje indirekte ndodh p.sh kur një shoqëri ka një aktiv/pasuri që një palë e tretë dëshiron të blejë. Sidoqoftë, shoqëria nuk ia shet palës së tretë aktivin, por pala e tretë blen aksionet e shoqërisë që zotëron aktivin, dhe në këtë mënyrë blen “indirekt” aktivin. Aksionet e blera mund të jenë të shoqërisë që mban aktivin ose, më shpesh, të shoqërive që kanë aksione në mënyrë direkte ose indirekte në shoqërinë që mban aktivin. Shpesh ka një numër të madh shoqërisht të ndërthurura ndërmjet pasurisë dhe pronarit përfundimtar indirekt, dhe shitja mund të ndodhë në cilëndo nga lidhjet në zinxhirin e aksionerëve.

Pika 1 e nenit 27/1 të ligjit trajton personin juridik që mban aktivin, si përfitues i të ardhurave nga shitja e aksioneve/kuotave/të drejtave, të ardhura këto të barabarta me vlerën e tregut të pjesës së aktivit të trajtuar si të transferuar. Vlera e tregut e një aktivi është ajo që pala e tretë do të marrë parasysh gjatë negociimit të kushteve të shitjes së aksioneve që shkakton ndryshimin e pronësisë. Njohja e kushteve të shitjes së aksioneve do të ndihmojë në përcaktimin e vlerës së tregut të një aktivi të trajtuar si të shitur. Gjithashtu, metoda të tjera relevante të përcaktimit të vlerës së tregut mund të përdoren. Shuma e të ardhurave të trajtuara si të marra nga shitja do të zvogëlohet më pas nga kostoja proporcionale e aktivit, duke përcaktuar fitimin ose humbjen për shitjen e vlerësuar të aktivit. Nëse ka një fitim, fitimi do të përfshihet në llogaritjen e të ardhurave të personit në vitin në të cilin ndodh transferimi i aktivit. Nëse ka një humbje, humbja do të jetë e zbritshme, por nëse kontribuon në një humbje të përgjithshme për vitin, atëherë kjo humbje mund të anulohet referuar nenit 27(2) të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

Pika 1 e nenit 27/1 trajton personin juridik si



riblerës të aktivitet që është trajtuar si i transferuar. Në këtë mënyrë, ndërkohë që personi juridik trajtohet sikur ta transferojë aktivin, ky person mbetet përsëri zotëruesi (pronari) i aktivitet. Sidoqoftë, kostoja e aktivitet do të ndryshojë për shkak të transferimit dhe riblerjes së supozuar. Kostoja e re e amortizueshme e aktivitet do të jetë e barabartë me të ardhurat e shitjes që personi juridik konsiderohet se do të marrë.

Për shembull, supozohet që kostoja e aktivitet është 80 milionë lekë dhe vlera e tregut është 100 milionë lekë. Në një transferim që sjell një ndryshim 100% të pronësisë, personi juridik fiton 20 milionë lekë (të ardhurat nga shitja 100 milionë–80 milionë kosto e aktivitet), e cila përfshihet në të ardhurat e tatueshme të personit juridik. Kostoja e asetit më pas rivlerësohet në 100 milionë lekë. Nëse aktivi është subjekt i amortizimit, ai do të llogaritet mbi koston prej 100 milionë (jo 80). Në mënyrë të ngjashme, nëse aktivi shitet më pas, atëherë vlera 100 milionë do të përdoret si kosto e aktivitet për të përcaktuar nëse ka një fitim ose humbje në shitje.

Duke zgjeruar shembullin, supozojmë se ndryshimi i pronësisë së personit juridik është 60%, p.sh. pala e tretë blen vetëm 60% të aksioneve të tij. Në këtë rast vetëm 60% e një aktivitet trajtohet si i shitur dhe vetëm 60% e vlerës së tregut të aktivitet trajtohet si fitim i shitjes. Më tej, vetëm 60% e koston së aktivitet do t'i atribuohet transferimit. Fitimi do të jetë 12 ($60\% \times 100 = 60$, minus $60\% \times 80 = 48$) dhe kjo shumë do të përfshihet në llogaritjen e të ardhurave të personit juridik. Kostoja e re e aktivitet do të jetë pjesa e koston së vjetër që i atribuohet pjesës së aktivitet që nuk disponohet ($80 - 48 = 32$) plus të ardhurat e shitjes të trajtuara si të marra (60). Pra, nëse aktivi është një aktiv i amortizueshëm baza nga e cila do të amortizohet pas ndryshimit të pronësisë do të jetë 92 ($32 + 60$).

Pika 1 e nenit 27/1 zbatohet në të gjitha rastet nëse personi juridik është rezident ose jorezident në Shqipëri dhe nëse pasuritë i atribuohen aseteve të një selie të përhershme në Shqipëri, por me kusht që për tre vitet paraardhëse mesatarja e qarkullimit të realizuar të jetë mbi 500 000 000 (pesëqind milionë) lekë. Tatimi mbi çdo fitimin që rezulton nga transferimi i aseteve aplikohet për të gjitha pasuritë pavarësisht nga vlera e tyre, pavarësisht nëse ato janë të luajtshme ose të paluajtshme dhe

llojin e industrisë në të cilën përdoren.

Pika 2 e nenit 27/1, synon të parandalojë tatimin e dyfishtë. Ky paragraf pengon mundësinë e tatimit të dyfishtë duke i dhënë prioritet tatimit sipas pikës 1 të nenit 27/1. Kur një person juridik paguan tatimin mbi fitimin për shkak të një transferimi të parashikuar sipas pikës 1, atëherë shitja e aksioneve që shkaktoi ndryshimin e pronësisë (që shkakton transferimin e supozuar) është i përjashtuar nga tatimi mbi fitimin.

Për shembull, supozojmë se një shoqëri shqiptare është tërësisht në pronësi të një shoqërie të vendosur në ishujt Kajman, që është tërësisht në pronësi të një personi rezident në një vend tjetër. Shoqëria shqiptare posedon pasuri të paluajtshme me një vlerë tregu më të lartë se kosto e saj. Një palë e tretë dëshiron të blejë pronën e paluajtshme, jo drejtpërsëdrejti, por duke blerë aksione në shoqërinë e ishujve Kajman. (supozohet se më shumë se 50% të vlerës së aksioneve në shoqërinë e ishujve Kajman i atribuohet pasurisë së paluajtshme, në Shqipëri). Pra, shoqëria shqiptare do të pësojë një ndryshim të pronësisë dhe kështu do të trajtohet si të transferojë pronën e paluajtshme për vlerën e tregut dhe pastaj do ta rimarrë pronën. Kjo do të rezultojë në një fitim që është i tatueshëm për shoqërinë shqiptare. Paragrafi 2 i nenit të ri 27/1 përjashton nga tatimi mbi fitimin shitjen e aksioneve në shoqërinë e ishujve Kajman, me kusht që shitja të tatohet në shoqërinë rezidente shqiptare.

Pika 3 e nenit 27/1 parashikon kërkesën për njoftim. Një person juridik që pëson një ndryshim të pronësisë duhet të njoftojë autoritetin tatimor brenda 45 ditëve nga ndryshimi. Njoftimi duhet të përmbajë detajet e ndryshimit, si palët e përfshira në transaksionet që shkaktojnë ndryshimin, si dhe marrëdhëniet e tyre me personin juridik në fjalë. Po kështu njoftimi përfshin edhe kushtet e transaksionit, përfshirë të ardhurat e shitjeve dhe mënyrën se si këto të ardhura janë llogaritur.

Pika 4 e nenit 27/1 shtrinë kërkesën e njoftimit të paragrafit 3) përtej ndryshimeve të pronësisë për të cilat zbatohet rregulli i transferimit të supozuar sipas pikës 1) (ndryshim pronësie me më shumë se 20 %). Kjo është efektivisht një kërkesë njoftimi për shitjet indirekte, ato ku realizohet fitimi nga shitja e aksioneve i cili kërkohet të tatohet. Si e tillë, kërkesa për njoftim aplikohet vetëm për transferimet indirekte të pasurisë së paluajtshme.



Për shembull, supozohet se një shoqëri shqiptare është tërësisht në pronësi të një shoqërie e vendosur në ishujt Kajman, që është tërësisht në pronësi të një personi rezident në një vend tjetër. Shoqëria shqiptare posedon pasuri të paluajtshme me një vlerë tregu më të lartë se kosto e saj. Një palë e tretë dëshiron të blejë pronën e paluajtshme të vendosur në Shqipëri, jo drejtpërsëdrejti, por duke blerë 15% të aksioneve në shoqërinë e ishujve Kajman. Supozojmë që më shumë se 50% e vlerës së aksioneve në shoqërinë e ishujve të Kajmanit i atribuohet pasurisë së paluajtshme të vendosur në Shqipëri, pasi neni 4, pika “e”, paragrafi “ii”, i ligjit trajton çdo fitim nga transferimi i aksioneve si me burim në Shqipëri.

Ndryshimi i pronësisë së shoqërisë shqiptare është më pak se 20% dhe kështu rregull i përcaktuar në nenin 27/1(1) nuk zbatohet. Megjithatë, fitimi në dispozicion të aksioneve ka një burim në Shqipëri sipas nenit 4. Pika 4 e nenit 27/1 kërkon që shoqëria shqiptare të njoftojë autoritetin tatimor për shitjen e 15% të aksioneve në shoqërinë mëmë të ishujve Kajman. Detyrimi për njoftim nuk zbatohet nëse shitja e aksioneve rezulton në më pak se 10% ndryshim në pronësinë e shoqërisë shqiptare. Ky kufi prej 10% vendoset pasi nën këtë nivel, shoqëria shqiptare mund të mos jetë në dijeni të transaksionit të shitjes. Megjithatë, edhe pse nuk pa pasur detyrim për njoftim, nëse ndryshimi është nën 10%, shitja e aksioneve mbetet e tatueshme në Shqipëri, me kusht që aksionet të marrin më shumë se 50% të vlerës së tyre nga pasuria e paluajtshme në Shqipëri.

Pika 5 e nenit 27/1 përcakton referencën në ligjin “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i cili parashikon dënimin për mosrespektimin e kërkesave të njoftimit të nenit 27/1 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”.

Pas pikës 3.13 “Parapagimet (Paradhëniet)”, shtohet pika 3.14 “Deklarimi dhe pagesa nga persona joresidentë specifikë”, me këtë përmbajtje;

3.14 “Deklarimi dhe pagesa nga persona joresidentë specifikë”

Neni 30/1 i ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat” përcakton deklaratë dhe procedurë pagesash të veçantë për jorezidentët, të cilët sipas pikës 1 “ç”, të nenit 16 të ligjit, janë subjekt i tatimit mbi fitimin, por për të cilët procedura e rregullt e parashikuar në nenet 29 dhe 30 nuk zbatohet. Procedura e deklarimit sipas nenit 29 të ligjit, kërkon që

tatimpaguesi të përgatisë bilancin kontabël dhe deklaratën e fitimit të tatueshëm për aktivitetet që janë subjekt i tatimit mbi fitimin në Shqipëri. Dispozita e nenit 30/1 përfshin rastet kur një tatimpagues jorezident tatohet për transaksionet dhe veprimtaritë jashtë Shqipërisë, megjithëse nuk ka detyrimin për të përgatitur bilancin kontabël dhe deklaratën tatimore sipas nenit 29. Në veçanti, ky mund të jetë një rast kur një person jorezident është subjekt i tatimit për një transaksion të izoluar të realizuar p.sh. në një zonë “offshore”, si p.sh., shitja e aksioneve në shoqërinë e ishujve Kajman të trajtuara në pikën 3.11/1 të këtij udhëzimi në lidhje me pikën 4, të nenit 27/1.

Pika 1 e nenit 30/1 parashikon një deklaram të veçantë të të ardhurave të tatueshme për jorezidentët, ku një jorezident është objekt i nenit 16(1) të ligjit. Për qëllime deklarimi si më sipër do të përdoret deklarata e fitimit të tatueshëm sipas formularit “Deklarimi dhe pagesa nga persona joresidentë specifikë”, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi. Pika 2 e nenit 30/1 përjashton këtë kategori nga sistemi i kësteve tatimore dhe sistemi i kreditimit të tatimit të huaj. Tatimi për këtë kategori deklarohet dhe paguhet në të njëjtën kohë kur paraqitet deklarata e tatim fitimit.

Pika 5.2 “Tatimi në burim nuk do të mbahet kur pagesa i bëhet”, zëvendësohet me këtë përmbajtje:

“5.2 Tatimi në burim nuk do të mbahet kur pagesa sipas faturës së lëshuar i bëhet:

a) Personave juridikë/fizikë tregtarë, të cilët janë tatimpagues të tatimit mbi fitimin, dhe kur pagesa bëhet për shërbime që përbëjnë aktivitetin normal të biznesit të tyre. Këta persona i deklarojnë këto të ardhura në të ardhurat e tatueshme të biznesit;

b) Personave juridikë/fizikë tregtarë që janë tatimpagues të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin dhe kur pagesa bëhet për shërbime që përbëjnë aktivitetin normal të biznesit të tyre. Këta persona i deklarojnë këto të ardhura në të ardhurat e tatueshme të biznesit;

c) Çdo personi juridik shqiptar apo të huaj për pagesa që lidhen me transportin ndërkombëtar të mallrave dhe pasagjerëve.

d) Personave jorezidentë, në lidhje me shërbime që ata kryejnë në kuadrin e veprimtarisë së tyre biznesore për persona rezidentë shqiptarë, vetëm kur parashikohet në dispozitat e marrëveshjeve për eliminimin e tatimit të dyfishtë që Shqipëria ka lidhur me vendin, rezident i së cilës është përfituesi



i të ardhurave. Aplikimi për shmangien e Tatimit në Burim bëhet në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve brenda afatit 2-vjeçar nga data e pagesës së faturës.

Në pikën 5.3 “Niveli i tatimit të mbajtur në burim”, fjalia e parë ndryshon me këtë përmbajtje;

“Tatimi në burim mbahet në masën 15% të pagesës bruto për pagesat e listuara në nenin 33 të ligjit dhe në masën 8% për dividendët dhe ndarjet e fitimit (me përjashtim të rasteve të dhëna në pikën 5.2 më lart)”.

Në pikën 5.6 “Vendimi për destinimin e fitimit”, togfjalëshi “...personat fizikë dhe juridikë...”, zëvendësohet me togfjalëshin “...personat juridikë...”

Pika 5.8 “Mbajtja e tatimit në burim mbi të ardhurat e ANTA-s”, shfuqizohet.

Pika 6 “Transferimi i çmimit”, shfuqizohet.

Në pikën 7.1 “Kreditimi i tatimit të paguar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë”, bëhen ndryshimet e mëposhtme;

Rasti 1, ndryshon me këtë përmbajtje;

Rasti 1. Një person juridik, rezident në Shqipëri, për vitin 2018, ka aktivitet në Shqipëri, si edhe një degë në Itali, ku realizon fitim neto si më poshtë:

- nga aktiviteti në Shqipëri: 30.000.000 lekë;
- nga aktiviteti në Itali: 16.000.000 lekë.

Në bazë të dispozitave të këtij ligji (neni 17) ky person, meqenëse është rezident shqiptar, i nënshtrohet tatimit në Shqipëri mbi fitimet e realizuara nga të gjitha burimet, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

Pra detyrimi tatimor në Shqipëri do të jetë:

- fitimi në total: 46.000.000 lekë
- tatim fitimi = $46.000.000 \times 15\% = 6.900.000$ lekë

Por, për fitimin që ka realizuar në Itali tatimpaguesi është tatuar atje (si jorezident) me tarifën e tatim fitimit në Itali që është 36%. Pra, tatimi i paguar në Itali:

$$16.000.000 \times 36\% = 5.760.000 \text{ lekë}$$

Tatimpaguesi sjell dokumentacionin e plotë që vërteton pagesën e këtij tatimi në Itali. Pas kësaj, organi tatimor shqiptar bën reduktimin e tatimit si më poshtë:

- tatimi që duhej të paguhej sikur të ardhurat e realizuara në Itali të realizoheshin në Shqipëri:

$16.000.000 \times 15\% = 2.400.000$ lekë. Pikërisht për këtë shumë do të bëhet reduktimi i tatimit, pra:

$$6.900.000 - 2.400.000 = 4.500.000 \text{ lekë, që është}$$

detyrimi përfundimtar i tatim fitimit që ky subjekt do të pagujë në Shqipëri.

Rasti 2, ndryshon me këtë përmbajtje;

Rasti 2. Supozojmë se i njëjti person juridik shqiptar ka një degë për ushtrimin e aktivitetit të tij në Maqedoni, ku tarifa e tatim fitimit është 10 %. Në këtë rast do të kishim:

- fitimi i realizuar në Shqipëri: 10.000.000 lekë

- fitimi i realizuar në Maqedoni: 6.000.000 lekë

Detyrimi tatimor në bazë të nenit 17 të ligjit:

$$16.000.000 \times 15\% = 2.400.000 \text{ lekë}$$

Por, për fitimin që ka realizuar në Maqedoni, tatimpaguesi është tatuar atje me tarifën 10%. Pra tatim fitimi i paguar në Maqedoni: $6.000.000 \times 10\% = 600.000$ lekë. Në këtë rast, meqenëse tatimi i paguar në Maqedoni (10%) nuk e kalon tatimin e pagueshëm për ato të ardhura në Shqipëri (15%), është pikërisht kjo shumë, pra 600.000 lekë që do të reduktohet nga detyrimi tatimor në total. Në këtë rast, pasi nga tatimpaguesi të jetë marrë dokumentacioni i plotë që ka realizuar të ardhurat dhe ka paguar tatimin në Maqedoni në këtë shumë, kreditimi i tatimit do të bëhet si më poshtë:

$2.400.000 - 600.000 = 1.800.000$ lekë, që është detyrimi përfundimtar i tatim fitimit që ky subjekt do të pagujë në Shqipëri.

Siç shihet, kreditimi (reduktimi) i tatim fitimit të paguar jashtë për fitime të realizuara jashtë, në asnjë rast nuk duhet të kalojë, pra mund të jetë më i vogël ose i barabartë, se tatimi që do të paguhej në Shqipëri nëse ato fitime do të realizoheshin në Shqipëri.

I njëjti parim vlen edhe për tatimin e individëve. Një individ rezident shqiptar do t'i kreditohet tatimi mbi të ardhurat i paguar jashtë Shqipërisë për të ardhura të realizuara jashtë (përkundrejt dokumenteve vërtetuese), por jo më shumë se tatimi që do të paguhej në Shqipëri nëse ato të ardhura do të realizoheshin në Shqipëri.

Pra, gjithmonë, kreditohet (ose reduktohet) tatimi i paguar jashtë Shqipërisë për fitime ose të ardhura të realizuara jashtë Shqipërisë dhe nuk preket tatimi i të ardhurave të realizuara në Shqipëri

Në pikën 7.2 “Kreditimi i humbjeve”, shembulli ndryshon me këtë përmbajtje:

Shembull. Një person juridik rezident shqiptar përveç aktivitetit në Shqipëri ka krijuar një degë në



Itali (p.sh. aty mund të ambalazhojë produktet dhe të përfundojë kontrata shitjeje për tregun Italian), dhe, dega në Itali vitin e parë rezulton me humbje dhe vitin e dytë me fitim. Të shohim si do të bëhet kreditimi (reduktimi) i humbjes në bazë të dispozitave të paragrafit të tretë të Nenit 37:

Për vitin 2017:

- fitimi në Shqipëri:

20.000.000

lekë

- humbja e degës në Itali:

2.000.000 lekë

- fitimi nga të gjitha burimet Brenda dhe jashtë Shqipërisë

(fitimi botëror ose global): 18.000.000 lekë

- tatim fitimi në Shqipëri:

$18.000.000 \times 15\% = 2.700.000$ lekë

- tatim fitimi në Itali: 0 leke

Për vitin 2018:

- fitimi në Shqipëri: 20.000.000 lekë

- fitimi në Itali: 16.000.000 lekë

- fitimi nga të gjitha burimet Brenda dhe jashtë Shqipërisë

(fitimi botëror):

36.000.000 lekë

- tatim fitimi në Shqipëri si rezident (neni 17) i llogaritur për fitimin global:

$36.000.000 \times 15\% =$

5.400.000 lekë

- tatim fitimi në Itali:

$16.000.000 \times 36\% =$

5.760.000 lekë

Kreditimi (reduktimi) i tatimit të paguar në Itali do të bëhet në mënyrën dhe në masën që vijon:

Nga fitimi i vitit 2018 i degës në Itali mbartet (zbritet) humbja e vitit të mëparshëm 16.000.000 – 2.000.000 = 14.000.000 lekë (sipas nenit 27). Për këtë shumë llogaritet tatimi sikur ky fitim të ishte realizuar në Shqipëri (sipas paragrafëve 1 dhe 2, të nenit 37), pra $14.000.000 \times 15\% = 2.100.000$. Është pikërisht kjo shumë që do të reduktohet nga detyrimi tatimor global. Pra detyrimi tatimor përfundimtar për tatimin mbi fitimin që do të paguajë personi juridik në Shqipëri për vitin 2018, është: $5.400.000 - 2.100.000 = 3.300.000$ lekë.

Tabela nr.1 “Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi”, zëvendësohet me tabelën nr.1 “Tatimi mbi të ardhurat nga punësimi”, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

Formulari “Deklarimi dhe pagesa nga persona jorezidentë specifike”, i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

Pasqyra nr.1

TABELA PËR TATIMIN MBI TË ARDHURAT PERSONALE NGA PUNËSIMI

E ardhura e tatueshme (në lekë/muaj)		Përqindje
Nga	Deri në (përfshirë)	
0	30.000	Zero për qind
30.001	150 000	+13 për qind të shumës mbi 30 000 lekë.
150 001	Më tepër	15 600 lekë + 23 për qind të shumës mbi 150 000 lekë


**FORMULAR DEKLARIMI DHE PAGESE NGA PERSONA JOREZIDENTË SPECIFIKE
(FORM ON DECLARATION AND PAYMENT BY CERTAIN NON-RESIDENTS)**

Periudha fiskale për të cilën plotësohet ky formular fillon më 01/01/ 20----deri 31/12/20----
(The fiscal period on which is filled this form begins from 01/01/ 20---- to 31/12/20__)

Shënim. Janë subjekt i plotësimit të këtij formulari vetëm tatimpaguesit jorezidentë të cilët janë të detyruar të deklarojnë dhe paguajnë tatim mbi fitimin nga shitja e aksioneve/drejtave sipas nenit 30/1 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar
Note: Are subject of filing this form only the nonresident taxpayers which are obliged to declare and pay tax on profits from the disposal of shares/rights, according to the article 30/1 of the Law “On Income tax”, as changed.

**Pjesa e I-rë. Informacion mbi tatimpaguesin raportues jorezident
(Part I - Information on nonresident reporting taxpayer)**

- Emri i tatimpaguesit joresident
Name of nonresident taxpayer.....
- Vendi i krijimit
Country of incorporation.....
- Rezidenca tatimore
Tax residence.....
- Adresa
Address.....
- Personi i kontaktit
Contact person.....
- Numri i telefonit & e-mail
Telephone number, e-mail
- Jepni një përshkrim të shkurtër të aktivitetit(ve) të biznesit
Provide brief description of business activity(s).....

**Pjesa e II-të. Informacion mbi deklarimin dhe pagesën.
(Part II. Information on declaration and payment).**

- % e pronësisë tek personi juridik resident shqiptar
% ownership in Albanian resident juridical person.....
- % e aksioneve/të drejtave të transferuara
% of shares/rights disposed.....
- Fitimet nga transferimi i aksioneve të drejtave
profits from the shares/rights disposed.....
- tatimi mbi fitimet e realizuara 15%
Tax on profits from the disposal of shares/rights 15%.....
- Shuma për t'u paguar
Amount to be paid.....

Pagesa bëhet në një llogari bankare të vecantë të administratës tatimore
Payment to be made in a specific bank account of tax administration

**Pjesa III Certifikim mbi saktësinë.
(Certification on the accuracy).**

Unë vërtetoj se informacioni i dhënë në këtë deklarim dhe në çdo dokumentacion që i bashkëngjitet atij është i njohur nga ana ime, është përgatitur në mirëbesim, bazuar në informacionin dhe evidencën më të mirë të disponuar.
I certify that the information given in this form and in any documents attached is prepared in good faith, based on the best information and evidence possessed.

Emri dhe mbiemri i administratorit/drejtorit
Name and surname of Administrator/Director

Nënshkrimi /Signature

UDHËZIM

Nr. 5, datë 22.2.2019

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN NR. 6, DATË 30.1.2015,
“PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHITUAR
NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 92/2014, datë 24.7.2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ministri i Financave dhe Ekonomisë,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr. 6, datë 30.1.2015, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në fund të nenit 36 “Zbatimi i shkallës së TVSH-së”, shtohen paragrafët me këtë përmbajtje:

“Gjithashtu, shkalla e reduktuar e tatimit mbi vlerën e shtuar aplikohet edhe për furnizime të tjera të mallrave dhe shërbimeve, në përputhje me përcaktimet e nenit 49 të ligjit për TVSH-në, si për shembull, për furnizimin e reklamave nga media audiovizive, librave të çdo lloji... etj.



Shembull 1. Kompania X që ushtron aktivitetin në fushën e mediave audiovizive (television) furnizon (shet) shërbimin e reklamës për kompaninë Y. Në këtë rast, kompania X lëshon faturë tatimore shiteje për kompaninë Y, me shkallë të reduktuar të TVSH-së në masën 6%.

Çdo veprimtari e kryer nga subjektet media audiovizive, veprimtari me natyrë tregtare, përveç reklamës, është e tatueshme me TVSH 20%. Pra, kur kompania X furnizon një program për një televizion tjetër, ose furnizon (shet) një kronike televizive, shet ose vë në dispozicion kohën televizive për transmetim etj., ajo kryen një shërbim të ndryshëm nga ai i shërbimit të reklamës dhe për pasojë nuk kryen furnizime shërbimi me shkallë të reduktuar të TVSH-së.

Ndërkohë, furnizimi i shërbimit të reklamave është furnizim i tatueshëm me shkallën standarde 20% kur furnizohet nga persona të tjerë të tatueshëm që nuk janë media audiovizive, përveç shërbimit të reklamave nga media e shkruar i cili është furnizim i përjashtuar nga TVSH-ja në zbatim të nenit 53, shkronja “j” të ligjit.”

Shembull 2. Një person i tatueshëm X, furnizon (shet) libra të çdo lloji, në formën tradicionale të një libri. Në këtë rast, ai lëshon faturë tatimore shiteje, duke aplikuar shkallën e reduktuar të TVSH-së prej 6 për qind. Çdo material i ofruar nga ky person, jo në formën tradicionale të librit, pavarësisht përmbajtjes së tij, që mund të lexohet nëpërmjet pajisjeve të tjera ndihmëse përfshirë ato elektronike, nuk është furnizim me shkallë të reduktuar të TVSH-së 6%.

Ndërkohë që, ky person i tatueshëm zëbret normalisht TVSH-në në përputhje me përcaktimet e ligjit dhe këtij udhëzimi, për të gjitha blerjet e mallrave dhe shërbimeve të realizuara në funksion të veprimtarisë së tij të tatueshme.”

2. Pas nenit 38, shtohet neni 38/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 38/1

Përjashtimi nga TVSH-ja për furnizimin e shërbimeve veterinarë

Bazuar në shkronjën “o” të nenit 51 të ligjit, furnizimi i shërbimeve veterinarë me përjashtim të shërbimeve veterinarë për kafshët shtëpiake, përjashtohet nga TVSH. Për qëllime të zbatimit të këtij udhëzimi, kafshët shtëpiake konsiderohen kafshët e shoqërimit sipas përcaktimit të legjislacionit të fushës për shërbimin veterinar.”

3. Neni 46, ndryshon me përmbajtjen si më poshtë:

“Neni 46

Përjashtimi i gazetave, revistave dhe reklamës nga media e shkruar

Bazuar në shkronjën “j” të nenit 53 të ligjit, furnizimi i shërbimeve të shtypshkronjave për gazetatat, furnizimi i gazetave, i revistave, si dhe furnizimi i shërbimit të reklamave nga media e shkruar, përjashtohen nga tatimi mbi vlerën e shtuar. Kështu, përjashtimi shtrihet për:

a) Shërbimin e shtypshkrimit të gazetave. Në këtë rast person i tatueshëm që kryen shërbimin e shtypshkrimit të gazetës në faturën tatimore të lëshuar për botuesin e gazetës, vlerës së tatueshme nuk i ngarkon TVSH. Furnizime të tjera të shtypshkrimit nuk përfutojnë nga përjashtimi.

b) Shitja e gazetave dhe e revistave. Çdo material i ofruar jo në formën tradicionale të një gazete, reviste, pavarësisht përmbajtjes së tyre, që mund të lexohet nëpërmjet pajisjeve të tjera ndihmëse përfshirë ato elektronike, nuk është i përjashtuar në kuptim të këtij neni. Furnizim i përjashtuar është edhe shitja e Fletores Zyrtare të Republikës së Shqipërisë, botuar nga Qendra e Publikimeve Zyrtare.

c) Furnizimi i shërbimit të reklamave nga media e shkruar është furnizim i përjashtuar. Vlera e tatueshme në faturat tatimore që mediat e shkruara lëshojnë për porositësit e reklamave, nuk ngarkohet me TVSH.”

4. Në nenin 48 “Eksportet”, pika 1, bëhen ndryshimet si më poshtë:

- Shkronja “b”, paragrafi i tretë, ndryshohet me këtë përmbajtje:

“Në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 57 të ligjit, në rastin kur furnizimi i shërbimit të përpunimit të mallrave joshqiptarë të destinuara për t’u riekportuar, kryhet nga një nënkontraktor, i cili e kryen këtë shërbim për llogari të shoqërisë së përpunimit aktiv që e ka kontraktuar (shoqëria eksportuese) e cila i nënshtrohet regjimit të përpunimit aktiv, ky furnizim shërbimi përpunimi është i tatueshëm me shkallën e TVSH-së 0%.”

- Shkronja “b”, paragrafi i gjashtë, riformulohet me këtë përmbajtje: “Furnizimi i shërbimit për përpunimin e mallrave joshqiptarë, të destinuara për t’u riekportuar të kryer nga nënkontraktorët e pajisur me autorizimin përkatës prej autoritetit doganor, për llogari të shoqërive të përpunimit aktiv, është furnizim shërbimi i tatueshëm me TVSH 0%.”

- Te paragrafi “-Kushtet e ekzistencës së kësaj natyre operacionesh janë: “, pika “iv”, togfjalëshi: “... është furnizim i tatueshëm me TVSH...” bëhet “... është furnizim i tatueshëm me TVSH 20%.”

- Në paragrafin me titull “Detyrime të veçanta” bëhen ndryshimet si vijon:



a) Në pikën “iv”, togfjalëshi “... shoqërohet me faturë tatimore me TVSH prej 20%, për vlerën e shërbimit të kryer”, bëhet “... shoqërohet me faturë tatimore me TVSH 0% për vlerën e shërbimit të kryer.”.

b) Paragrafi i parë pas pikës “iv”, ndryshon me këtë përmbajtje:

“Për zbatimin e këtyre rregullave çdo person i tatueshëm nënkontraktor, menjëherë me marrjen e autorizimit të autoritetit doganor, paraqet një kërkesë në Drejtorinë Rajonale Tatimore përkatëse. Kërkesës i bashkëngjitet një kopje e autorizimit të lëshuar nga autoriteti doganor, i cili e njëh nënkontraktorin si të tillë, si dhe një kopje të kontratës së lidhur me kontraktorin (shoqërinë e përpunimit aktiv).

Drejtoria Rajonale Tatimore lëshon për nënkontraktorin, autorizimin, “Për përfshirjen në operacione të përpunimit aktiv”, jo më vonë se 30 ditë nga data e lëshimit të autorizimit nga ana e autoritetit doganor. Vlefshmëria e këtij autorizimi është e njëjtë me atë të lëshuar nga autoriteti doganor. Për çdo ndryshim nënkontraktori është i detyruar të njoftojë autoritetin tatimor përkatës.”.

c) Në vazhdim të fjalisë: “Të gjitha autorizimet e lëshuara evidentohen nga Drejtoria Rajonale Tatimore në një regjistër të veçantë ku shënohet emri i personit të tatueshëm (nënkontraktori), NIPT, adresa, lloji i veprimtarisë, kontraktori për të cilin punon, data e lëshimit të autorizimit dhe afati i vlefshmërisë.” shtohet fjalia me përmbajtje:

“Furnizimet e shërbimit në kuadër të regjimit të përpunimit aktiv nuk kryhen nga nënkontraktorë të paautorizuar nga autoritetet doganore dhe tatimore përkatëse.”.

ç) Në paragrafin e fundit, fjalia me përmbajtje: “Shoqëria e përpunimit aktiv që rieksporion këto mallra ka të drejtë gjithashtu të zbresë TVSH-në e ngarkuar në faturën e lëshuar nga nënkontraktori për punimet e kryera në kuadër të regjimit.” ndryshon me këtë përmbajtje:

“Shoqëria e përpunimit aktiv që rieksporion këto mallra nuk ka të drejtë të zbresë TVSH-në e ngarkuar në faturën e marrë prej saj, për furnizimin e shërbimeve të përpunimit të mallrave joshqiptare, të kryera në kuadër të regjimit prej 1 janar 2019, pasi furnizimi është i tatueshëm me 0 % dhe jo më 20%.”.

5. Në nenin 60 “Trajtimi fiskal i firove /humbjeve gjatë procesit të prodhimit, magazinimit, transportit”, bëhen këto ndryshime:

- Në pikën 1, në fund të paragrafit të parë, shtohet togfjalëshi “...”, siç përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e normativave për firot, humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë prodhimit, magazinimit, transportimit etj., të njohura për qëllime fiskale.”.

- Pika 2 ndryshon me këtë përmbajtje:

“Në rastin e furnizimit të energjisë elektrike, “humbje gjatë shpërndarjes së energjisë elektrike” do të konsiderohet përqindja e humbjeve të energjisë elektrike në shpërndarje, siç përcaktohet në vendimin e Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e normativave për firot, humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë prodhimit, magazinimit, transportimit etj., të njohura për qëllime fiskale.”.

Për qëllime të këtij udhëzimi, niveli i humbjeve në rrjet të energjisë elektrike është vjetor dhe niveli maksimal i humbjeve është përqindja sipas përcaktimit në vendimin e Këshillit të Ministrave të sipërpërmendur.

Në rast se përqindja faktike vjetore e humbjeve tejkalon përqindjen sipas përcaktimit në vendimin e Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e normativave për firot, humbjet, dëmtimet dhe skarcot gjatë prodhimit, magazinimit, transportimit etj., të njohura për qëllime fiskale”, për qëllime të TVSH-së konsiderohet përqindja e përcaktuar sipas VKM-së.

Në rast se përqindja faktike vjetore e humbjeve është më e ulët se përqindja vjetore e përcaktuar me VKM, për qëllime të TVSH-së konsiderohet përqindja faktike e humbjeve.

Brenda tre muajve të vitit pasardhës, personi i tatueshëm që operon në sektorin e shpërndarjes së energjisë në bashkëpunim me administratën tatimore kryejnë rakordimet dhe rregullimet përkatëse.”.

6. Modeli i deklaratës së tatimit mbi vlerën e shtuar, i përcaktuar në nenin 67, të udhëzimit, zëvendësohet me modelin e deklaratës së tatimit mbi vlerën e shtuar sipas këtij udhëzimi.

7. Modeli i librit të shitjeve dhe blerjeve, i përcaktuar në nenin 68 të udhëzimit, zëvendësohet me modelin e librit të shitjeve dhe blerjeve sipas këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj

Nipti

Viti

Muaji

Pa veprimtari

Emri i Shoqërisë

Nipti i Shoqërisë

Viti për të cilin plotësohet libri (yyyy)

Muaji për të cilin plotësohet libri - muaji nga 01 deri 12

Plotëso PO nëse gjatë muajit nuk është bërë asnjë transaksion.

Ratura			Bleresi			Totali shitjeve	Shitjet e përjashtuara	Shitjet pa TVSH	Eksporte mallrash	Rendimzime me 0%	Shitje me shkallë 20%		Shitje me shkallë 10%		Shitje me shkallë 6%		Shitje regjimi agjentëve të udhëimit / marzhi frimtit / shitje në ankand		Autogarkesë TVS Hënë shite		Bonxhi keq	
Nr Raturës	Numi Serial	Data (dd/mm/yyyy)	Emri tregtar / personi	Rrethi	NIPT						Vlera e Tatuashme	Tvsh	Vlera e Tatuashme	Tvsh	Vlera e Tatuashme	Tvsh	Vlera e Tatuashme	Tvsh	Vlera e Tatuashme	Tvsh	Vlera e Tatuashme	Tvsh
a	b	c	ç	d	dh	$\frac{a+b+c+g+h+i+j+k+l+m+n+o+p+q}{44}$	ë	f	g	g	h	$\frac{h}{(h \times 20\%)}$	j	$k = (j \times 10\%)$	l	$l = (l \times 6\%)$	m	$n = (m \times 20\%)$	n	$\frac{n}{(n) \times 20\%}$	p	$\frac{p}{(p \times 20\%)}$
						0						0		0		0		0				
						0						0		0		0		0				
						0						0		0		0		0				
						0						0		0		0		0				
						0						0		0		0		0				
						0						0		0		0		0				
						0						0		0		0		0				
						0						0		0		0		0				
						0						0		0		0		0				
						0						0		0		0		0				
						0						0		0		0		0				
						0						0		0		0		0				
						0						0		0		0		0				
						0						0		0		0		0				
Shuma totale						0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Kutiasipos Rmblantit të Deklarimit dhe Pagesës së TVSH-së							kuta (9)	kuta (10)	kuta (11)	kuta (12)	kuta (13)	kuta (14)	kuta (15)	kuta (16)	kuta (17)	kuta (18)	kuta (19)	kuta (20)	kuta (21)	kuta (22)	kuta (23)	kuta (24)

Emri Mbiemri

Shpjegim:

Në rastin kur ky libër do të printohet, për qëllime të ruajtjes/ mbajtjes së dokumentacionit, çdo faqe e printuar duhet të ketë në krye përmbajtjen / rreshtat nga 1 në 12.

Nr. i rreshtave mund të shtohet në përputhje me nr. e transaksioneve.



Libri i Blerjeve

Shoqëria

NIPT-i

Viti

Muaji

Pa veprimtari

Emri i Shoqërisë

NIPT-i i Shoqërisë

Viti për të cilin plotësohet libri (yyyy)

Muaji për të cilin plotësohet libri – muaji nga 1 deri 12

Plotëso PO nëse gjatë muajit nuk është bërë asnjë transaksion.

Rruga			Shkëmb			Totali (përfshirë TVSH)	Blerje														Të tjera veprime														
Nr. Faturës	Numri Seria	Data (dd/mm/yyyy)	Emri tregtar/ personi	Rrëthi	NIPT /Kod Romanit		Të përfshijura në TVSH për zbatime p aresh	Blerje investive brenda vendi pa TVSH	Importe të përfshijura a të investimit pa TVSH	Import matina të përfshijura	Importet matina me shkallë 20%		Importet matina me shkallë 10%		Importet matina me shkallë 6%		Importet të investimit meshkallë 20%		Nga Fumitorë/Vendas meshkallë 20%		Nga Fumitorë/Vendas meshkallë 10%		Nga Fumitorë/Vendas meshkallë 6%		Të investimit nga Fumitorë/Vendas me shkallë 20%		Nga Fumitorë/Vendas meshkallë 10%		Aaborga dhe TVSH në blerjet me të drejtë kreditimi		Regullimet TVSH të zbatimit		Veprimet të bonitetit leq		
											Vlera e Tatueshme	Tvsh	Vlera e Tatueshme	Tvsh	Vlera e Tatueshme	Tvsh	Vlera e Tatueshme	Tvsh	Vlera e Tatueshme	Tvsh	Vlera e Tatueshme	Tvsh	Vlera e Tatueshme	Tvsh	Vlera e Tatueshme	Tvsh	Vlera e Tatueshme	Tvsh	Vlera e Tatueshme	Tvsh	Vlera e Tatueshme	Tvsh	Vlera e Tatueshme	Tvsh	Vlera e Tatueshme
a	b	c	ç	d	dh	dh	e	f	g	g	h	h = (h) x 20%	j	k = (j) x 10%	l	l = (l) x 6%	m	n = (m) x 20%	o = (o) x 20%	p	q = (q) x 10%	r	m = (r) x 6%	s	dh = (d) x 20%	t	dh = (d) x 6%	u	v = (v) x 20% (%)	x	xh = (x) x 20% (%)	(x)	z = (z) x 20% (%)	(y)	
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0
							0				0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		0		


**DEKLARATA E TATIMIT MBI
VLERËN E SHITUAR**
(2) Periudha tatimore
Numri i Vendosijes së Dokumentit (NVD)
(Vetëm për përdorim zyrtar)

(1) Numri Serial: _____

 Numri Identifikues i Personit të Tatueshëm (NIPT):
 Emri Tregtar i Personit të Tatueshëm:
 Emri Mbiemri i Personit Fizik:
 Adresa:
 Qyteti/Komuna/Rrethi:
 Numri Telefonit:

 (3) _____
 (4) _____
 (5) _____
 (6) _____
 (7) _____

Informacioni i mësipërm (rubrikat 4,5,6,7) duhet të jetë i saktë dhe i azhurnuar


[8] Shënimi 'X' nëq gjatë muajit nuk është bërë asnjë transaksion.

TVSH e llogaritur për muajin

Vlera e tatueshme

TVSH e llogaritur

(9) Shitje të përjashtuara

(10) Shitje pa TVSH

(11) Eksporte mallrash

(12) Furnizime me shkallë 0%

(13) Shitje të tatueshme (me shkallë 20%)

(15) Shitje të tatueshme (me shkallë 10%)

(17) Shitje të tatueshme (me shkallë 6%)

(19) Shitje të tatueshme sipas regjimeve të agjentit të udhëtitimit/ të marzhit të fitimit/ të shitjeve në ankand (20%)

(21) Autogarkesë TVSH-së në shitje (reverse charge)

(23) Borxhi i keq

 (25) Totali TVSH-së së llogaritur $\{(14)+(16)+(18)+(20)+(22)+(24)\}$

(9)	
(10)	
(11)	
(12)	
(13)	(14)
(15)	(16)
(17)	(18)
(19)	(20)
(21)	(22)
(23)	(24)
	(25)

TVSH e zbritshme për muajin

Vlera e tatueshme

TVSH e zbritshme

(26) Blerje të përjashtuara, TVSH jo e zbritshme/pa TVSH

(27) Blerje investimi brenda vendit pa TVSH

(28) Importe të përjashtuara të investimit pa TVSH

(29) Import mallra të përjashtuara nga TVSH

(30) Import mallra me shkallë tatimore 20%

(32) Import mallra me shkallë tatimore 10%

(34) Import mallra me shkallë tatimore 6%

(36) Importe të investimit me TVSH 20%

(38) Blerje nga furnitor vendas me shkallë 20%

(40) Blerje nga furnitor vendas me shkallë 10%

(42) Blerje nga furnitor vendas me shkallë 6%

(44) Blerje të Investimit Brenda vendit me TVSH 20%

(46) Blerje nga fermerët vendas (6%)

(48) Autogarkesë e TVSH-së në blerje me të drejtë kreditimi (reverse charge)

(50) Rregullime të TVSH-së së zbritshme

(52) Borxhi i keq

 (54) Totali TVSH-së së zbritshme
 $\{(31)+(33)+(35)+(37)+(39)+(41)+(43)+(45)+(47)+(49)+(51)+(53)\}$

 (55) Teprica e TVSH-së së zbritshme për muajin $\{(25)-(54)\}$ nëq $\{(25)<(54)\}$

 (56) TVSH I DETYRUESHËM PËR TU PAGUAR $\{(25)-(54)\}$ nëq $\{(25)>(54)\}$

(26)	
(27)	
(28)	
(29)	
(30)	(31)
(32)	(33)
(34)	(35)
(36)	(37)
(38)	(39)
(40)	(41)
(42)	(43)
(44)	(45)
(46)	(47)
(48)	(49)
(50)	(51)
(52)	(53)
	(54)

	(55)
	(56)

Data dhe Firma e Personit të Tatueshëm - Deklaroj nën përgjegjësi time që informacioni i mësipërm është i plotë dhe i saktë.



Deklaratë për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (DTVSH)

1. Numri serial perdoret nga Drejtoria Rajonale Tatimore dhe shërbën për të azhronuar regjistrimet tuaja kur paraqet deklarata.

2. Periudha Tatimore është muaji i parashitë nga data e parë deri në ditën e fundit të gjitha transakcioneve (Shitjet, Blerjet) dhe llogaritet mujore të TVSH-së të kryera gjatë kësaj periudhe duhet të përshihen në këtë deklarata.

Të dhëna të Personit të Tatueshëm

3. Numri identifikues i Personit të Tatueshëm (NPT/NUIS) është numri i vetëm që ju përfaqëson dhe identifikon në të gjitha marrëdhëniet me Administratën Tatimore Qendrore. Npt/ Nuis duhet të vendoset detyruesisht në çdo faturë që lëshohet ose merret.

4. Emri Tregtar i Personit të Tatueshëm është emri tregtar me të cilin ju jeni regjistruar në QKR ose Drejtoria Rajonale Tatimore sipas legjislacionit tashmë në fuqi dhe që tregohet në certifikatën tuaj të regjistrimit a NPT/NUIS.

5. Emri, Mbiemri i Personit Fizik vendoset kur veprimtaria ekonomike kryhet nga një Person Fizik dhe nuk ka emër tregtar.

6. Adresa tregëtare për vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë tuaj ekonomike. Kjo adresë është e treguar edhe në certifikatën tuaj të NPT/NUIS.

7. Numri i Telefonit (nqs keni) tregon numrin e telefonit në vendin kryesor të ushtrimit të veprimtarisë tuaj ekonomike.

Shënime: Nëqëse ndonjë nga të dhënat e rubrikave 4,5,6,7 ka ndryshuar, jeni të detyruar të deklaroni në kohë, çdo ndryshim pranë QKR-së ose Drejtorisë Rajonale Tatimore ku jeni i regjistruar.

8. Njëqësi ju nuk keni kryer asnjë transaksion gjatë muajit, shënoni një "X" në kutinë 8. Sipas mënyrës së deklarimit, plotësoni datën dhe firmën duke deklaruar në këtë mënyrë që informacioni i dhënë në deklarata është i plotë dhe i saktë.

TVSH e llogaritur për muajin

9. Nga kolona "8" -"Shitje të përjashtuara" e librit tuaj të shënjëve nxirri totalin e të gjithë shitjeve të përjashtuara të muajit dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 9 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen shitjet e përjashtuara sipas Kapitullit 8 seksioni 1 të ligut, për të cilat nuk llogaritet TVSH.

10. Nga kolona "8" -"Shitje pa TVSH" e librit tuaj të shënjëve nxirri totalin e të gjithë shitjeve pa TVSH të muajit dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 10 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen shitjet e tatueshme në Shqipëri për të cilat nuk llogaritet TVSH. **11. Nga kolona "g" -"Eksporte mallrash"** të librit tuaj të shënjëve nxirri totalin e të gjithë eksporteve të mallrave me shkallë tatimore 0% të bëra për muajin dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 11 të Deklaratës tuaj. Furnizimet Eksporte sipas nenit 57 të ligut tatohen me shkallë 0%.

12. Nga kolona "gj" -"Furnizime me shkallë 0%" e librit tuaj të shënjëve nxirri totalin e të gjithë furnizimeve me shkallë tatimore 0% të bëra për muajin dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 10 të Deklaratës tuaj, furnizime sipas Kapitullit 8 seksioni 3 paragrafi të mallrave që deklarohen në kutinë 11.

13. Nga kolona "h" -"Vlera e Tatueshme për shitje me shkallë 20%" nxirri totalin për transakcione të bëra gjatë muajit të cilat sipas ligut që i nënshtrohen shkallës tatimore TVSH 20% dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 13 të Deklaratës tuaj. (vlera +/-)

14. Nga kolona "a" e Librit të shënjëve **"TVSH për shitje me shkallë 20%",** nxirri totalin e tvsh-së për muajin për shitje me shkallë 20% dhe shumën e përftuar vendosni në kutinë 14 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 14 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së paraqitur në kutinë 13 (vlera +/-).

15. Nga kolona "i" e Librit të shënjëve **"Vlera e Tatueshme për shitje me shkallë 10%"** nxirri totalin për transakcione të bëra gjatë muajit të cilat sipas ligut, i nënshtrohen shkallës tatimore TVSH 10% dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 15 të Deklaratës tuaj. (vlera +/-).

16. Nga kolona "gj" e Librit të shënjëve **"TVSH për shitje me shkallë 10%",** nxirri totalin e TVSH-së për muajin për shitje me shkallë 10% dhe shumën e përftuar vendosni në kutinë 16 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 16 duhet të jetë e barabartë me 10% të vlerës së paraqitur në kutinë 15. (vlera +/-).

17. Nga kolona "j" e Librit të shënjëve **"Vlera e Tatueshme për shitje me shkallë 6%"** nxirri totalin për transakcione të bëra gjatë muajit të cilat sipas ligut, i nënshtrohen shkallës tatimore TVSH 6% dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 17 të Deklaratës tuaj. (vlera +/-).

18. Nga kolona "h" e Librit të shënjëve **"TVSH për shitje me shkallë 6%",** nxirri totalin e TVSH-së për muajin për shitje me shkallë 6% dhe shumën e përftuar vendosni në kutinë 18 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 18 duhet të jetë e barabartë me 6% të vlerës së paraqitur në kutinë 17. (vlera +/-).

19. Nga kolona "m" e Librit të shënjëve **"Vlera e Tatueshme për shitje sipas regjimit të agjentëve të udhëtimi/ marzhi fitimit /shitje në ankand"** nxirri totalin për transakcione të bëra gjatë muajit dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 19 të Deklaratës tuaj. Këtu shënit të tatueshme i nënshtrohen shkallës 20% të TVSH-së.

20. Nga kolona "n" e Librit të shënjëve **"TVSH për shitje regjimi agjentëve të udhëtimi/ marzhi fitimit /shitje në ankand"** nxirri totalin e TVSH-së të shënjëve për muajin dhe shumën e përftuar vendosni në kutinë 20 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 20 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së paraqitur në kutinë 19.

21. Nga kolona "nj" e Librit të shënjëve **"Vlera e Tatueshme për Autogarkesë TVSH në shitje"** nxirri totalin për transakcione për të cilat llogariten autogarkesë TVSH në shitje të bëra gjatë muajit dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 21 të Deklaratës tuaj. Këtu transakcione deklarohen sipas shkallës tatimore standarde dhe/ose të reduktuar sipas legjislacionit tashmë në fuqi.

22. Nga kolona "o" e Librit të shënjëve **"Vlera e autogarkuar në shitje"**, nxirri totalin e TVSH-së për transakcione për të cilat llogaritet autogarkesë TVSH në shitje për muajin dhe shumën e përftuar vendosni në kutinë 22 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 22 duhet të jetë e barabartë me vlerën e kutisë 21 shumëzuar me % përkatëse standarde dhe/ose të reduktuar sipas legjislacionit tashmë në fuqi.

23. Nga kolona "p" e Librit të shënjëve **"Vlera e Tatueshme për veprime të Borshit e keq"** nxirri totalin për muajin të transakcioneve sipas nenit 84 të Ligjit, dhe vendosni në kutinë 23 të Deklaratës tuaj. Shkalla e zbatueshme e TVSH-së është sipas legjislacionit tashmë në fuqi (vlera +/-).

24. Nga kolona "q" e Librit të shënjëve **"TVSH për veprime të Borshit e keq"**, nxirri totalin e TVSH-së për akte të Borsit të keq për muajin dhe shumën e përftuar vendosni në kutinë 24 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 24 duhet të jetë e barabartë me vlerën e kutisë 23 shumëzuar me % përkatëse standarde dhe/ose të reduktuar sipas legjislacionit tashmë në fuqi.

25. Llogaritja totalin e TVSH së mbledhshme për muajin, duke mbledhur TVSH e llogaritur për Shitje të tatueshme me 20% (kutta 14), Shitje të tatueshme me 10% (kutta 16), Shitje të tatueshme me 6% (kutta 18), TVSH e llogaritur për shitje të llogaritur sipas regjimeve të agjentëve udhëtimi/marzhi fitimit/ shitje në ankand me 20 % (kutta 20), TVSH e llogaritur për transakcione të blerjes së shërbimeve nga persona jo rezident e autogarkuar në shitje me shkallë standarde dhe/ose të reduktuar (kutta 22), TVSH e mbledhshme nga veprime të Borsit të keq me shkallë standarde dhe/ose të reduktuar (kutta 24). Shumën plotësojeni në kutinë 25. (vlera +/-).

TVSH e zbritshme gjatë Muajit

26. Nga kolona "8" e Librit tuaj të blerjeve **"Blerje të përjashtuara, me TVSH jo të zbritshme dhe pa tvsh"**, nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 26 të Deklaratës tuaj. Këtu do të regjistrohen blerjet e përjashtuara me TVSH jo të zbritshme dhe pa tvsh, përveç blerjeve të hulla të kryera për investime të cilat regjistrohen veçmas në kutinë 27. Për blerjet me TVSH jo të zbritshme nuk do të bëhet zbritje e TVSH.

27. Nga kolona "r" e Librit tuaj të blerjeve **"Blerje investive brenda vendit pa TVSH"**, Këtu regjistrohen vetëm blerjet e kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit të kryera brenda vendit dhe pa TVSH, si p.sh. blerjet e përjashtuara, me TVSH jo të zbritshme dhe pa tvsh, për investime. Nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 27 të Deklaratës tuaj.

28. Nga kolona "g" e Librit tuaj të blerjeve **"Importe të përjashtuara të investimit pa TVSH"**, nxirri totalin e importeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 28 të Deklaratës tuaj. Këtu do të regjistrohen të gjitha importet e mallrave të përjashtuara nga TVSH, përveç importeve të përjashtuara për investime të cilat regjistrohen veçmas në kutinë 28.

29. Nga kolona "h" e Librit tuaj të blerjeve **"Vlera e Tatueshme e Importe mallra me shkallë 20%"**, e Librit tuaj të blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importeve të mallrave me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 30 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 30 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 30 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së paraqitur në kutinë 29.

30. Nga kolona "k" e Librit tuaj të blerjeve **"Vlera e Tatueshme e Importe mallra me shkallë 10%"**, e Librit tuaj të blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importeve të mallrave me shkallë 10% dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 31 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 10% dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 31 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 31 duhet të jetë e barabartë me 10% të vlerës së paraqitur në kutinë 29.

31. Nga kolona "l" e Librit tuaj të blerjeve **"Vlera e Tatueshme e Importe mallra me shkallë 6%"**, e Librit tuaj të blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importeve të mallrave me shkallë 6% dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 32 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 6% dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 32 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 32 duhet të jetë e barabartë me 6% të vlerës së paraqitur në kutinë 29.

32. Nga kolona "m" e Librit tuaj të blerjeve **"TVSH për blerje nga furnitorë vendas me shkallë 20%"** e Librit tuaj të blerjeve, mbidhni totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 33 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 33 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së paraqitur në kutinë 32.

33. Nga kolona "n" e Librit tuaj të blerjeve **"TVSH për blerje nga furnitorë vendas me shkallë 10%"** e Librit tuaj të blerjeve, mbidhni totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 34 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 34 duhet të jetë e barabartë me 10% të vlerës së paraqitur në kutinë 32.

34. Nga kolona "o" e Librit tuaj të blerjeve **"TVSH për blerje nga furnitorë vendas me shkallë 6%"** e Librit tuaj të blerjeve, mbidhni totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 35 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 35 duhet të jetë e barabartë me 6% të vlerës së paraqitur në kutinë 32.

35. Nga kolona "p" e Librit tuaj të blerjeve **"TVSH për blerje nga furnitorë vendas me shkallë 20%"** e Librit tuaj të blerjeve, mbidhni totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 36 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 36 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së paraqitur në kutinë 32.

36. Nga kolona "q" e Librit tuaj të blerjeve **"TVSH për blerje nga furnitorë vendas me shkallë 10%"** e Librit tuaj të blerjeve, mbidhni totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 37 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 37 duhet të jetë e barabartë me 10% të vlerës së paraqitur në kutinë 32.

37. Nga kolona "r" e Librit tuaj të blerjeve **"TVSH për blerje nga furnitorë vendas me shkallë 6%"** e Librit tuaj të blerjeve, mbidhni totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 38 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 38 duhet të jetë e barabartë me 6% të vlerës së paraqitur në kutinë 32.

38. Nga kolona "s" e Librit tuaj të blerjeve **"Vlera e tatueshme nga furnitorë vendas me shkallë 20%"** e Librit tuaj të blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 39 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen të gjitha blerjet brenda vendit përveç, asyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit që deklarohen në kutinë 44 (vlera +/-).

39. Nga kolona "t" e Librit tuaj të blerjeve **"Vlera e tatueshme nga furnitorë vendas me shkallë 10%"** e Librit tuaj të blerjeve, mbidhni totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 40 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 40 duhet të jetë e barabartë me 10% të vlerës së paraqitur në kutinë 39.

40. Nga kolona "u" e Librit tuaj të blerjeve **"Vlera e tatueshme nga furnitorë vendas me shkallë 6%"** e Librit tuaj të blerjeve, mbidhni totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 41 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 41 duhet të jetë e barabartë me 6% të vlerës së paraqitur në kutinë 39.

41. Nga kolona "v" e Librit tuaj të blerjeve **"TVSH për blerje nga furnitorë vendas me shkallë 20%"** e Librit tuaj të blerjeve, mbidhni totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 42 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 42 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së paraqitur në kutinë 39.

42. Nga kolona "w" e Librit tuaj të blerjeve **"TVSH për blerje nga furnitorë vendas me shkallë 10%"** e Librit tuaj të blerjeve, mbidhni totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 43 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 43 duhet të jetë e barabartë me 10% të vlerës së paraqitur në kutinë 39.

43. Nga kolona "x" e Librit tuaj të blerjeve **"TVSH për blerje nga furnitorë vendas me shkallë 6%"** e Librit tuaj të blerjeve, mbidhni totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 44 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 44 duhet të jetë e barabartë me 6% të vlerës së paraqitur në kutinë 39.

44. Nga kolona "y" e Librit tuaj të blerjeve **"Vlera e tatueshme nga furnitorë vendas me shkallë 20%"** e Librit tuaj të blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 45 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen të gjitha blerjet brenda vendit përveç, asyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit që deklarohen në kutinë 44 (vlera +/-).

45. Nga kolona "z" e Librit tuaj të blerjeve **"Vlera e tatueshme nga furnitorë vendas me shkallë 10%"** e Librit tuaj të blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 46 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 46 duhet të jetë e barabartë me 10% të vlerës së paraqitur në kutinë 45.

46. Nga kolona "aa" e Librit tuaj të blerjeve **"Vlera e tatueshme nga furnitorë vendas me shkallë 6%"** e Librit tuaj të blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 47 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 47 duhet të jetë e barabartë me 6% të vlerës së paraqitur në kutinë 45.

47. Nga kolona "ab" e Librit tuaj të blerjeve **"Vlera e tatueshme nga furnitorë vendas me shkallë 20%"** e Librit tuaj të blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 48 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 48 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së paraqitur në kutinë 45.

48. Nga kolona "ac" e Librit tuaj të blerjeve **"Vlera e tatueshme nga furnitorë vendas me shkallë 10%"** e Librit tuaj të blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 49 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 49 duhet të jetë e barabartë me 10% të vlerës së paraqitur në kutinë 45.

49. Nga kolona "ad" e Librit tuaj të blerjeve **"Vlera e tatueshme nga furnitorë vendas me shkallë 6%"** e Librit tuaj të blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 50 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 50 duhet të jetë e barabartë me 6% të vlerës së paraqitur në kutinë 45.

50. Nga kolona "ae" e Librit tuaj të blerjeve **"Vlera e tatueshme nga furnitorë vendas me shkallë 20%"** e Librit tuaj të blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 51 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 51 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së paraqitur në kutinë 45.

51. Nga kolona "af" e Librit tuaj të blerjeve **"Vlera e tatueshme nga furnitorë vendas me shkallë 10%"** e Librit tuaj të blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 52 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 52 duhet të jetë e barabartë me 10% të vlerës së paraqitur në kutinë 45.

52. Nga kolona "ag" e Librit tuaj të blerjeve **"Vlera e tatueshme nga furnitorë vendas me shkallë 6%"** e Librit tuaj të blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 53 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 53 duhet të jetë e barabartë me 6% të vlerës së paraqitur në kutinë 45.

53. Nga kolona "ah" e Librit tuaj të blerjeve **"Vlera e tatueshme nga furnitorë vendas me shkallë 20%"** e Librit tuaj të blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 54 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 54 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së paraqitur në kutinë 45.

54. Nga kolona "ai" e Librit tuaj të blerjeve **"Vlera e tatueshme nga furnitorë vendas me shkallë 10%"** e Librit tuaj të blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 55 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 55 duhet të jetë e barabartë me 10% të vlerës së paraqitur në kutinë 45.

55. Nga kolona "aj" e Librit tuaj të blerjeve **"Vlera e tatueshme nga furnitorë vendas me shkallë 6%"** e Librit tuaj të blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 56 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 56 duhet të jetë e barabartë me 6% të vlerës së paraqitur në kutinë 45.

përftuar, në kutinë 30 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç asyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 36.

31. Nga kolona "l" -"TVSH në Import për mallra me shkallë 20%" e Librit tuaj të blerjeve, nxirri totalin e TVSH-së në import për mallrat jo të investimit dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 31 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 31 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së paraqitur në kutinë 30.

32. Nga kolona "j" -"Vlera e Tatueshme e Importe mallra me shkallë 10%" e Librit tuaj të blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importeve të mallrave me shkallë 10% dhe plotësoni shumën e përftuar, në kutinë 32 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 10%, përveç asyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 36.

33. Nga kolona "k" -"TVSH në Import për mallra me shkallë 6%" e Librit tuaj të blerjeve, nxirri totalin e TVSH-së në import për mallrat jo të investimit dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 33 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 33 duhet të jetë e barabartë me 6% të vlerës së paraqitur në kutinë 30.

34. Nga kolona "i" -"Vlera e Tatueshme e Importe mallra me shkallë 20%" e Librit tuaj të blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importeve të mallrave me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përftuar, në kutinë 34 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20%, përveç asyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 36.

35. Nga kolona "m" -"TVSH në Import për mallra me shkallë 10%" e Librit tuaj të blerjeve, nxirri totalin e TVSH-së në import për mallrat jo të investimit dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 35 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 35 duhet të jetë e barabartë me 10% të vlerës së paraqitur në kutinë 30.

36. Nga kolona "n" -"Vlera e Tatueshme e Importe investimi me shkallë 20%" e Librit tuaj të blerjeve, për muajin, nxirri totalin e vlerës së tatueshme të importit me shkallë 20% dhe plotësoni shumën e përftuar, në kutinë 36 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen vetëm importet e mallrave me shkallë 20% të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit, të cilat deklarohen në kutinë 36.

37. Nga kolona "r" -"TVSH në Import për investimi me shkallë 20%" e Librit tuaj të blerjeve, nxirri totalin e TVSH-së në import për mallrat të investimit dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 37 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 37 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së paraqitur në kutinë 36.

38. Nga kolona "nj" -"Vlera e tatueshme nga furnitorë vendas me shkallë 20%" e Librit tuaj të blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 38 të Deklaratës tuaj. Këtu regjistrohen të gjitha blerjet brenda vendit përveç, asyre të kryera për qëllime investimi në pasurinë e subjektit që deklarohen në kutinë 44 (vlera +/-).

39. Nga kolona "o" -"TVSH për blerje nga furnitorë vendas me shkallë 20%" e Librit tuaj të blerjeve, mbidhni totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 39 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 39 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së paraqitur në kutinë 38.

40. Nga kolona "p" -"Vlera e tatueshme nga furnitorë vendas me shkallë 10%" e Librit tuaj të blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 40 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 40 duhet të jetë e barabartë me 10% të vlerës së paraqitur në kutinë 38.

41. Nga kolona "q" -"TVSH për blerje nga furnitorë vendas me shkallë 6%" e Librit tuaj të blerjeve, mbidhni totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 41 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 41 duhet të jetë e barabartë me 6% të vlerës së paraqitur në kutinë 38.

42. Nga kolona "r" -"Vlera e tatueshme nga furnitorë vendas me shkallë 20%" e Librit tuaj të blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 42 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 42 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së paraqitur në kutinë 38.

43. Nga kolona "s" -"Vlera e tatueshme nga furnitorë vendas me shkallë 10%" e Librit tuaj të blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 43 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 43 duhet të jetë e barabartë me 10% të vlerës së paraqitur në kutinë 38.

44. Nga kolona "t" -"Vlera e tatueshme nga furnitorë vendas me shkallë 6%" e Librit tuaj të blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 44 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 44 duhet të jetë e barabartë me 6% të vlerës së paraqitur në kutinë 38.

45. Nga kolona "u" -"Vlera e tatueshme nga furnitorë vendas me shkallë 20%" e Librit tuaj të blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 45 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 45 duhet të jetë e barabartë me 20% të vlerës së paraqitur në kutinë 38.

46. Nga kolona "v" -"Vlera e tatueshme nga furnitorë vendas me shkallë 10%" e Librit tuaj të blerjeve, nxirri totalin e këtyre blerjeve dhe plotësoni shumën e përftuar në kutinë 46 të Deklaratës tuaj. Vlera në kutinë 46 duhet të jetë e barabartë me 10% të vlerës së paraqitur në kutinë 38.

**VENDIM****Nr. 16, datë 18.2.2019**

**MBI SHTYRJEN E AFATIT TË ZBATIMIT
TË KONTRATËS TIP PËR SHITBLERJEN
E ENERGJISË ELEKTRIKE NDËRMJET
SHOQËRISË SË PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE/KESH SHA,
AKSIONET E SË CILËS
KONTROLLOHEN PLOTËSISHT OSE
PJESËRISHT NGA SHTETI DHE
FURNIZUESIT TË SHËRBIMIT
UNIVERSAL PËR PERIUdhËN
1.1.2018–31.12.2018 DHE KONTRATËS PËR
SHITBLERJEN E SASISË SË TEPËRT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE QË REZULTON
PAS PËRMBUSHJES SË KËRKESËS SË
KLIENTËVE QË PËRFITOJNË NGA
SHËRBIMI UNIVERSAL, ME QËLLIM
MBULIMIN E HUMBJEVE NË RRJETIN
E SHPËRNDARJES PËR PERIUdhËN
KOHORE 1.1.2018–31.12.2018”**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 20, germa “h”, të ligjit nr. 43/2015, datë 22.5.2003, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 104, pika 4, germa a, e ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative” nenit 5 dhe nenit 14 të VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016 “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.2.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike në lidhje me miratimin e shtyrjes së afatit të zbatimit të kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal, për periudhën 1.1.2018–31.12.2018 dhe kontratës për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e

humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018”.

konstatoi se:

Bordi i ERE-s, me vendimin e tij nr. 98, datë 30.4.2018, ka vendosur:

1. Të miratojë kontratën për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018.

Bordi i ERE-s, me vendimin e tij nr. 132, datë 7.6.2018 ka vendosur:

1. Të miratojë kontratën tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal për periudhën 1.1.2018–31.12.2018,

Konstatojmë se:

- KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. nuk kanë dakortësuar ende për vitin 2019 “Kontratën për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes dhe kontratën tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal”.

- Me qëllim zgjidhjen e problematikave që pengojnë miratimin e kontratës për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike, që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, organizoi një seancë dëgjimore në datë 29.1.2019. Në këtë seancë u diskutua mbi problemet që palët kanë konstatuar në kontratën në fuqi, e që lidhen me përcaktimin e sasive të energjisë elektrike të livruara konform zbatimit të kësaj kontrate për vitin 2018.

- Mungesa e kontratave të dakortësuarra e për rrjedhojë edhe e vendimit të ERE-s lidhur me këtë çështje, nuk i liron shoqëritë nga detyrimi për të furnizuar konsumatorët me energji elektrike, por as nuk i transformon këto shoqëri në shtojca të njëra-tjetrës. KESH sh.a. ka për detyrim të furnizojë OSHEE sh.a., me një sasi të caktuar energjie



elektrike, kundrejt çmimit të përcaktuar nga organi kompetent shtetëror bazuar në parashikimet e legjislacionit në fuqi për Sektorin e Energjisë Elektrike.

- Nga shqyrtimi i korrespondencës KESH sh.a.–OSHEE sh.a., gjatë gjithë vitit 2018 lidhur me zbatimin e kontratave të sipërcituara është vërejtur se, KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. kanë këndvështrime të ndryshme ndaj parashikimeve kontraktore ndërmjet palëve dhe për pasojë ka pasur refuzime të disa faturave nga të dyja palët, si dhe kanë pranuar pa kundërshtime të tjera.

- Palët nuk i janë drejtuar ERE-s më herët me kërkesë për interpretimit të dispozitave të “kontratës për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 98, datë 30.4.2018.

- Kontrata për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2018–31.12.2018”, miratuar me vendimin e Bordit nr. 98, datë 30.4.2018, mbështetur në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, ndryshuar me VKM-në nr. 729, datë 8.12.2017, draftohet e dakortësohet nga palët dhe përcillet për miratim në ERE.

- Kontrata për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për periudhën kohore 1.1.2019–31.12.2019”, nuk është depozituar në ERE për miratim.

- ERE ka detyrimin të rregullojë marrëdhënien kontraktore mes palëve KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. në funksion të parashikimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të

licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, ndryshuar me VKM nr. 729, datë 8.12.2017.

- Pas shqyrtimit të rrethanave në lidhje me kontratat e sipërcituara, ERE e gjykon të arsyeshme që të shtyjë afatin e zbatimit të këtyre kontratave deri në paraqitjen e draft kontratave për vitin 2019 nga KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a., dhe miratimin e tyre nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Shtyrjen e afatit të zbatimit të kontratës për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 98, datë 30.4.2018, deri në paraqitjen e draft kontratës për vitin 2019 nga KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. dhe miratimin e saj nga ERE.

2. Shtyrjen e afatit të zbatimit të kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/ KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal për periudhën 1.1.2018–31.12.2018, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 132, datë 7.6.2018, deri në paraqitjen e draft kontratës për vitin 2019 nga KESH sh.a. dhe OSHEE sh.a. dhe miratimin e saj nga ERE.

3. Për periudhën deri në miratimin e kontratës për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike / KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe OSHEE sh.a. për vitin 2019, nëse sasia e energjisë së livruar dhe të marrë, ndryshon nga sasia e energjisë së programuar për livrim, faturimet do të axhustohen nga palët në këtë kontratë për të reflektuar ndryshimet e devijimet midis programit dhe sasisë aktuale të livruar.

4. Në çdo rast sasia dhe çmimi i shitjes së energjisë elektrike për qëllime të furnizimit të Furnizuesit të Shërbimit Universal, nga shoqëria e prodhimit e ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik, është sipas nenit 5, pika 2 e VKM-së nr. 244, datë 30.3.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të



shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, i ndryshuar.

5. Ky vendim e shtrin fuqinë juridike që nga data 1.1.2019 dhe shteron me marrjen e vendimit të Bordit të ERE-s për miratimin e kontratës për shitblerjen e sasisë së tepërt të energjisë elektrike që rezulton pas përmbushjes së kërkesës së klientëve që përfitojnë nga shërbimi universal, me qëllim mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes për vitin 2019, si dhe kontratës tip për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet shoqërisë së prodhimit të energjisë elektrike/ KESH sh.a., aksionet e së cilës kontrollohen plotësisht ose pjesërisht nga shteti dhe Furnizuesit të Shërbimit Universal për periudhën për vitin 2019.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike, nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI
Adriatik Bego

VENDIM Nr. 17, datë 18.2.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “AYEN ENERGY TRADING” SHA, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “d”; nenit 5, pika 1, germa “d”; nenit 10, pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimi, transferimi, rinovimi ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen

e datës 18.2.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e për gatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi kërkesën e shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Ayen Energy Trading” sh.a., zotëron licencën me nr. 230, seria FK14, në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 30, datë 31.3.2014. Afati i kësaj licence përfundon në datën 31.3.2019.

- Shoqëria “Ayen Energy Trading” sh.a., ka aplikuar në ERE për rinovimin e licencës në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 93 prot., datë 28.1.2019.

- Aplikanti ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës, në zbatim të afateve të parashikuara në nenin 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, jo me vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

- Aplikimi i shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germa “a” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa “a”, “b”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, germa “a”, “b”, “c” dhe “f”, pika 4.7.1, germa “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me “Formati dhe dokumentacioni për aplikim”, neni 9, pika 1, germa “b” (mungon prokura e përfaqësuesit); “Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, neni 9, pika 1, germa “d” (Informacion i detajuar tekniko-financiar lidhur me përmbushjen e këtyre



kontratave), neni 9, pika 4.7.1, germa “a” (Të dhëna për klientët dhe energjinë e furnizuar), do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 10, pika 9 dhe nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi të ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për rinovimin e licencës nr. 230, seria FK14, të shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a., në veprimtarinë e Furnizimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Adriatik Bego

VENDIM Nr. 18, datë 18.2.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SHOQËRISË “AYEN ENERGY TRADING” SHA, NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”; nenit 5, pika 1 germa “e”; nenit 10, pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 18.2.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e

Monitorimit të Tregut mbi kërkesën e shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Ayen Energy Trading” sh.a., zotëron licencën me nr. 229, seria T14, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 29, datë 31.3.2014. Afati i kësaj licence përfundon në datën 31.3.2019.

- Shoqëria “Ayen Energy Trading” sh.a., ka aplikuar në ERE për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 93/1 prot., datë 28.1.2019.

- Aplikanti ka paraqitur kërkesën për rinovimin e licencës, në zbatim të afateve të parashikuara në nenin 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, jo më vonë se 2 muaj para përfundimit të kohëzgjatjes së vlefshmërisë së licencës së dhënë.

- Aplikimi i shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat “a” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor neni 9, pika 2, germat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e” është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal neni 9, pika 3, germat “a”, “b”, “c” dhe “d” është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat “a”, “b” dhe “d”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me: “Formati dhe dokumentacioni për aplikim”, neni 9, pika 1, germa “b”), (mungon prokura e përfaqësuesit), “Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, neni 9, pika 4.8, do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 10, pika 9 dhe nenit 11, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e



licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për rinovimin e licencës nr. 229, seria T14, të shoqërisë “Ayen Energy Trading” sh.a., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar.

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Adriatik Bego

VENDIM

Nr. 19, datë 18.2.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E DISA SHITESAVE NË “RREGULLAT E PÛRKOHSHME TË MEKANIZMIT BALANCUES”, MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 193, DATË 24.11.2017

Në mbështetje të neneve 16, 98 dhe 100, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 19, pika 1, germa “P” dhe nenit 26 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 18.2.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike “Mbi fillimin e procedurës për miratimin e disa shitesave në ‘Rregullat e përkohshme të mekanizmit balancues’”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017,

konstatoi se:

- Shoqëria “OST” sh.a. me anë të shkresës nr. 8531 prot., datë 14.12.2018, bën me dije se ka evidentuar diferenca (humbje) në bilancin financiar nga aplikimi i mekanizmit balancues sipas “Rregullave të përkohshme të mekanizmit balancues”, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017.

- OST sh.a., bëri me dije se, këto humbje vijnë si pasojë e aplikimit të katër koeficientëve konform gjendjes së sistemit (ACE) kundrejt pjesëmarrësve të tregut (BRP) dhe aplikimit të dy koeficientëve kundrejt Ofruesit të Shërbimit Balancues (BSP).

- OST sh.a., kërkon rishikimin e aplikimit të këtyre koeficientëve nga ERE, duke mos paraqitur propozim konkret, por vetëm duke parashtruar se, hyrja në fuqi e Rregullave Definitive të Balancimit mund të shtrihet në kohë përgjatë vitit 2019, si dhe referuar rregullave në fuqi, ku këto diferenca që evidentohen që do të jenë subjekt i rregullimit tarifor nga ana e ERE-s.

- ERE me anë të shkresës nr. 791/1 prot., datë 26.12.2018, solli në vëmendje të OST sh.a. se, rregullat e balancimit të energjisë elektrike propozohen për shqyrtim dhe miratim në ERE nga OST sh.a., pas konsultimit me palët e treta dhe kërkoj të paraqesin propozime konkrete në lidhje me rishikimin e koeficientëve të vendosura në mekanizmin balancues.

- OST sh.a., në vijim me shkresën nr. 26/1, datë 14.1.2019 ka kërkuar rishikimin e “Rregullave të përkohshme për mekanizmin balancues të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 193, datë 24.11.2017, duke propozuar:

Në nenin 12, pika 2, pas germës “c”, të shtohet germa “d”, me këtë përmbajtje:

- Të dispeçuar për të reduktuar prodhimin e energjisë elektrike ose rritur konsumin si shërbim balancimi, do të paguhet me çmimin e llogaritur si HUPX DAM çmim të një ore specifike, të shumëzuar me një faktor prej 0.5 për çdo MWh të disbalancës.

Në nenin 12, pika 3, pas germës “c” të shtohet germë “d” me këtë përmbajtje:

- Të dispeçuar për të rritur prodhimin e energjisë elektrike ose të reduktojë konsumin si shërbim balancimi që do të paguhet me çmimin e llogaritur si HUPX DAM çmim të një ore specifike, të shumëzuar me një faktor prej 0.5 për çdo MWh të disbalancës.

- ERE, me propozimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit dhe në bashkëpunim me të gjithë pjesëmarrësit e sektorit të energjisë elektrike, miraton rregullat e balancimit, mbështetur në parashikimet e nenit 98 të ligjit 43/2015 Për sektorin e energjisë elektrike, ndryshuar.

- Sekretariati i Komunitetit të Energjisë i ka ofruar ndihmë teknike OST sh.a. në lidhje me hartimin e Rregullave të Përkohshme për Mekanizimin e Balancimit të Energjisë Elektrike,



ndaj edhe çdo ndryshim të ardhëm të këtyre rregullave OST sh.a. duhet të konsultohet me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë.

- Siguria ekonomiko financiare e OST sh.a. ka rëndësi të madhe për tregun energjetik, ndaj ERE e konsideron të përshtatshme hapjen e procesit të rishikimit të këtyre rregullave duke përfshirë në konsultime me të gjithë palët e interesit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e propozimit të OST sh.a. për miratimin e disa shtesave në “Rregullat e përkohshme të mekanizmit balancues të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e ERE-s nr.193, datë 24.11.2017, si më poshtë:

Në nenin 12, pika 2, pas germës “c”, të shtohet germa “d”, me këtë përmbajtje:

- *Të dispeçuar për të reduktuar prodhimin e energjisë elektrike ose rritur konsumin si shërbim balancimi, do të paguhet me çmimin e llogaritur si HUPX DAM çmim të një ore specifike, të shumëzuar me një faktor prej 0.5 për çdo MWh të disbalancës.*

Në nenin 12, pika 3, pas germës “c”, të shtohet germë “d” me këtë përmbajtje:

- *Të dispeçuar për të rritur prodhimin e energjisë elektrike ose të reduktojë konsumin si shërbim balancimi që do të paguhet me çmimin e llogaritur si HUPX DAM çmim të një ore specifike, të shumëzuar me një faktor prej 0.5 për çdo MWh të disbalancës.*

2. OST sh.a., të kryejë simulimet dhe argumentimet përkatëse që faktojnë se koeficientet dhe propozimet për rishikim janë të drejtë, t’ia bëjë me dije, si dhe të konsultojë propozimet me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, si dhe palët e interesit.

3. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, aplikuesin, si dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Adriatik Bego

VENDIM

Nr. 20, datë 18.2.2019

MBI NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 245, DATË 26.11.2018, “PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË ‘RENRGY TRADING GROUP’” SHPK NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 104, pika 4, germa “a”, dhe nenit 113, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurës administrative”, nenit 4, pika 1, germa “d”; nenit 5, pika 1, germa “d”; nenit 10, pikat 1 dhe 3 dhe nenit 16 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a” të “Rregullave për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 18.2.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut mbi “Plotësimin e kushtit të vendosur në vendimin nr. 245, datë 26.11.2018, “Për licencimin e shoqërisë ‘Renrgy Trading Group’” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 245, datë 26.11.2018, ka vendosur si më poshtë:

1. Të licencojë shoqërinë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Shoqëria brenda 3 muajve nga marrja dijeni e këtij vendimi, të depozitojë në ERE strukturën e ndërtimit të shoqërisë.

3. Shoqëria përpara se të fillojë operimin në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike të njoftojë ERE-n mbi implementimin e sistemit të platformës IT që do të përdorë.

4. Në rastin e mospërmbushjes së këtyre kushteve nga ana e subjektit, ERE rezervon të drejtën e rishikimit të këtij vendimi.

- Shoqëria “ReNRGY Trading Group” sh.p.k.,



me shkresat e protokolluara në ERE me nr. 107, datë 1.2.2019 dhe nr. 107/1, datë 8.2.2019, ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

- Organigramën dhe listën e personelit të shoqërisë sipas profilit, të nënshkruara nga administratori,

- Marrëveshjen e datës 9.1.2019, për shërbimin e sistemit IT, me subjektin “Novita d.o.o”.

- Sa më sipër, rezulton se shoqëria “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., ka plotësuar kushtin e vendosur në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 245, datë 26.11.2018.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e një ndryshimi në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 245, datë 26.11.2018, “Për licencimin e shoqërisë “Renrgy Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”

2. Pikat 2, 3 dhe 4, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 245, datë 26.11.2018, “Për licencimin e shoqërisë “Renrgy Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”, shfuqizohen.

3. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Adriatik Bego

VENDIM

Nr. 21, datë 18.2.2019

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “KASTRATI ENERGY” SHPK, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “d”, nenit 5, pika 1, germa “d” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin,

rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.2.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për licencim e shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Kastrati Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 111 prot., datë 1.2.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k. plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, gjerat “a”, “b” dhe “c”). Plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gjerat “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”), plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gjerat “a”, “b”, “c” dhe “d”). Plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.7, gjerat “a”, “b”, “c”, “d”, “f” dhe pika 4.7.1, germa “c”). Plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Neni 9, pika 3, germa “b” (bilanci financiar i tre viteve të fundit);

- Neni 9, pika 4.7, germa “e” (sistemi IT);

- Neni 9, pika 4.7.1, germa “a” (të dhëna për klientët dhe energjinë e furnizuar) dhe germa “b” (niveli i tensionit dhe mënyra e realizimit të matjes për klientët),

do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s



VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit me energji elektrike, për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Adriatik Bego

VENDIM

Nr. 22, datë 18.2.2019

**MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
LICENCIMIN E SHOQËRISË “KASTRATI
ENERGY” SHPK, NË VEPRIMTARINË E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa “d”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, nenit 4, pika 1, germa “e”; nenit 5, pika 1, germa “e”; nenit 10, pika 1 dhe nenit 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, si dhe nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 18.2.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, për licencimin e shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike,

konstatoi se:

- Shoqëria “Kastrati Energy” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE, me nr. 111 prot., datë 1.2.2019, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

- Aplikimi i shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për

dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Format i aplikimit (neni 9, pika 1, germa “a”, “b”, “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germa “a”, “b”, “c”, “d” dhe “e”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germa “a”, “c” dhe “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germa “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte.

Në lidhje me mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- Dokumentacioni financiar dhe fiskal, neni 9, pika 3, germa “b” (bilanci financiar i tri viteve të fundit). Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, neni 9, pika 4.8, germa “a” dhe “d” (sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u tregtuar në GWh/sipas viteve),

do të njoftohet subjekti që në bazë të nenit 11, pika 1 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, t’i paraqesë ato brenda afateve.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “Kastrati Energy” sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar (pesëvjeçar).

2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Adriatik Bego



VENDIM
Nr. 23, datë 18.2.2019

MBI PËRCAKTIMIN E ÇMIMIT TË SHITJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA FURNIZUESI I MUNDËSISË SË FUNDIT PËR MUAJIN JANAR 2019

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 87 pika 4, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017 i ndryshuar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 144, datë 25.6.2018 “Mbi rishikimin e “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”; nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordin i Entit Rregullator të Energjisë, në mbledhjen e tij të datës 18.2.2019, mbasi shqyrtoi

relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike të furnizuar nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit” për muajin janar 2019,

konstatoi se:

- OSHEE sh.a., me anë të shkresës nr. 2224 prot., datë 29.1.2019, paraqiti aplikimin për çmimin e shitjes së energjisë elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV, të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit, për muajin janar 2019.

- Informacioni i dërguar në këtë shkresë është përgatitur në mbështetje të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 201, datë 4.12.2017 “Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit”, i ndryshuar.

- OSHEE sh.a., ka llogaritur çmimin e shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin janar 2019, si vijon:

Raporti i OSHEE sh.a. në lidhje me çmimin e llogaritur për FMF për muajin janar 2019

Janar 2019			Njësia
a	Çmimi maksimal i blerjes në treg të parregulluar ose blerja nga prodhuesit me përparësi	14.33	Lekë/kWh
b	Kthim për riskun i përcaktuar në përqindje për vitin (3%)	0.43	Lekë/kWh
c	Çmimi maksimal i blerjes në periudhën relevante	14.76	Lekë/kWh
d	Kosto administrative të furnizuesit të mundësisë së fundit	1.80	Lekë/kWh
e	Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit	0.75	Lekë/kWh
f	Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes	1.5	Lekë/kWh
Çmimi i energjisë (c+d+e+f)		18.81	Lekë/kWh

* Çmimi i energjisë reaktive (çmimi i energjisë aktive *15%)

* Çmimi i energjisë në pikë (çmimi i energjisë aktive + çmimi i energjisë reaktive)

- Shoqëria OSHEE sh.a., bashkëlidhur këtij aplikimi, në mënyrë të përmbledhur ka paraqitur informacion mbi realizimin e procedurave të blerjes së energjisë elektrike, nga tregu i parregulluar.

- Çmimi më i lartë i realizuar për muajin janar 2019 është çmimi prej 114.77 euro/MWh për blerjen e sasisë prej 9,968 MWh nga shoqëria “GEN-I TIRANA” për fashën orare 07:00–23:00, në periudhën 18.1.2019–24.1.2019 (loti 2). Për rrjedhojë, çmimi 114.77 euro/MWh do të merret në konsideratë për përcaktimin e çmimit për klientët FMF për muajin janar.

- Sipas informacionit të shoqërisë OSHEE sh.a., për realizimin e procedurave të blerjes së energjisë elektrike në tregun e parregulluar, data 16.1.2019 është data kur kompania ofertuese GEN-I TIRANA (çmimi më i lartë) ka dalë fituese në

fazën përfundimtare të negociimit. Data 16.1.2019, duhet të merret në konsideratë për përcaktimin e kursit të këmbimit EUR/lekë. Sipas publikimeve në faqen zyrtare të Bankës së Shqipërisë rezulton se, kursi i këmbimit i përdorur në llogaritjen e çmimit të FMF-së, për datën 16.1.2019 është 1 EUR=124.27 LEKË.

- Vërehet se, në këtë aplikim për çmimin FMF për muajin janar 2019, OSHEE sh.a. ka zbatuar me korrektësi përcaktimet e nenit 8 të Metodologjisë së përcaktimit të çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për sa i përket çmimit maksimal të blerjes.

- OSHEE sh.a. ka rillogaritur kostot administrative (CA) bazuar në buxhetin e shoqërisë për vitin 2019, por nisur nga fakti që ERE me vendimin nr. 268, datë 21.12.2018, la në fuqi pikën



1 dhe pikën 3, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 190, datë 30.8.2018, “Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë “OSHEE” sh.a. për tarifat e shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike sipas nivelit të tensionit dhe lënien në fuqi të çmimeve me pakicë për klientët që shërbehen nga Furnizuesi i Shërbimit Universal për vitin 2018”, OSHEE sh.a. me e-mail-in e datës 7.2.2019 protokolluar në ERE me nr. 132, informon se, do të vazhdojë të aplikojë koston administrative si në vitin 2018 (1.79 lekë/kWh), për llogaritjen e çmimit FMF-35 kV.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të transmetimit, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 266, datë 21.12.2018 “Mbi përcaktimin e tarifës së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike nga shoqëria “OST” sh.a. për vitin 2019”, është 0.75 lekë/kWh.

- Tarifa e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes në nivelin e tensionit 35 kV, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 268, datë 21.12.2018 “Mbi lënien në fuqi të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 190, datë 30.8.2018 në lidhje me tarifën e përdorimit të rrjetit të shpërndarjes sipas nivelit të tensionit dhe çmimet me pakicë për klientët fundorë që shërbehen nga furnizuesi i shërbimit universal për vitin 2019” është 1.5 lekë/kWh.

- Nga verifikimi i informacionit dhe përlogaritjeve të paraqitura nga “OSHEE” sh.a., rezulton se, çmimi për shitjen e energjisë elektrike për klientët që furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit (FMF), për muajin janar 2019 është 18.73 lekë/kWh.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të miratojë çmimin e furnizimit me energji elektrike për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV të cilët furnizohen nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin janar 2019 në vlerën 18.73 lekë/kWh.

2. Drejtoria e Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit, të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Adriatik Bego

VENDIM

Nr. 4, datë 1.2.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E KOMISIONIT KOMBËTAR RREGULLATOR NR. 30, DATË 18.7.2017, “PËR LICENCIMIN E SHA, UJËSJELLËS- KANALIZIME BERAT-KUÇOVË”, I NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 13, 14, 16 dhe 17, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), VKM nr. 958, datë 6.5.2009 “Për miratimin e kategorive të licencimit dhe të procedurave për aplikim për licence” (VKM nr. 958), si dhe vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 29, datë 8.12.2009 “Për procedurat e dhënies dhe rinovimit të licencave profesionale për subjektet juridike e fizike që ushtrojnë veprimtari në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, e ndryshuar (Rregullore e licencimit),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 1.2.2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike dhe Drejtoria Juridike mbi kërkesën e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Berat-Kuçovë sh.a. (UK Berat-Kuçovë) sh.a., për ndryshim të licencës për shkak të ndryshimit të drejtuesit ligjor,

VËREN SE:

1. Shoqëria UK Berat-Kuçovë me shkresën nr. 25 prot. datë 10.1.2019, me lëndë “Përcjellje e dokumenteve të nevojshëm për ndryshimin e drejtuesit ligjor” ka paraqitur pranë Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU) kërkesën për rinovim të licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor të shoqëruar me dokumentacionin sipas përcaktimeve të parashikuara në VKM-në nr. 958 dhe Rregullore e licencimit.

2. Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR) e gjeti paraqitjen e kërkesës së UK Berat-Kuçovë për rinovim licence për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor në konformitet me kriteret dhe procedurën e parashikuar në VKM-në nr. 958 dhe Rregulloren e licencimit.

3. UK Berat-Kuçovë ka përditësuar ekstraktin e



regjistrin tregtar për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor me dokumentacionin si më poshtë:

- Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të UK Berat–Kuçovë nr. 178, datë 31.12.2018, “Për lirimimin e administratorit të sh.a. Ujësjetllës-Kanalizime Berat–Kuçovë”;

- Me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme të UK Berat–Kuçovë nr. 179, datë 31.12.2018 “Për emërimin e administratorit të sh.a. Ujësjetllës-Kanalizime Berat–Kuçovë”.

4. Referuar kërkesës dhe dokumentacionit shoqërues, rezulton:

a) ERRU-ja ka licencuar shoqërinë UK Berat–Kuçovë, me vendimin nr. 30, datë 18.7.2017, “Për licencimin e sh. a Ujësjetllës-Kanalizime Berat–Kuçovë”, i ndryshuar me një afat 4-vjeçar, ku shoqëria autorizohet të ofrojë shërbimin e grumbullimit dhe shpërndarjes së ujit për konsum publik, si dhe largimit të ujërave të ndotura;

b) Asambleja e Përgjithshme e Ujësjetllës-Kanalizime Berat–Kuçovë sh.a. me vendimin nr. 178, datë 31.12.2018, “Për lirimimin e administratorit të sh.a. Ujësjetllës-Kanalizime Berat–Kuçovë” dhe vendimin nr. 179, datë 31.12.2018 “Për emërimin e administratorit të sh.a. Ujësjetllës-Kanalizime Berat–Kuçovë” ka vendosur ndryshimin e drejtuesit ligjor të shoqërisë UK Berat–Kuçovë duke emëruar z. Pelivan Sinaj.

5. ERRU-ja, në vlerësimin e kërkesës për ndryshimin e licencës për efekt të ndryshimit të drejtuesit ligjor ka marrë në konsideratë përmbushjen nga ana e UK Berat–Kuçovë sh.a. të kërkesave të ligjit nr. 8102, të VKM-së nr. 958 dhe Rregullores së licencimit, në mënyrë të veçantë sa i takon garantimit që i licencuari të veprojnë në përputhje me kushtet e licencës së tij dhe të mbrojnë interesat e konsumatorëve në lidhje me cilësinë, eficientën, vazhdueshmërinë dhe garancinë e shërbimit.

Për gjithë sa më sipër Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i UK Berat–Kuçovë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Në pikën 1, të vendimit të KKRR-së nr. 30, datë 18.7.2017, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Berat–Kuçovë”, i ndryshuar, bëhet ndryshimi si më poshtë:

“Drejtues ligjor: Pelivan Sinaj”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM

Nr. 5, datë 1.2.2019

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË UJËSJETLLËS-KANALIZIME VORË

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015 “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi i KKRR-së nr. 40), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015 “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largim e përpunimit të ujërave të ndotura” (vendimi i KKRR-së nr. 42),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 1.2.2019, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Teknike-Ekonomike dhe Sektori Juridik mbi kërkesën e Ujësjetllës-Kanalizime Vorë sh.a., për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura,

konstatoi se:

- Shoqëria Ujësjetllës-Kanalizime Vorë (UK Vorë) është licencuar me vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 44, datë 14.10.2016, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjetllës-Kanalizime Vorë” (vendimi i KKRR-së nr. 44) pas përfundimit të



riorganizimit sipas ndarjes së re territoriale, bazuar në pikën 3, të kreut II, të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura” (VKM nr. 63).

- Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Vorë ka aplikuar për herë të parë pranë ERRU-së, me shkresën nr. 577 prot., datë 26.6.2018, me lëndë “Kërkesë për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm dhe largimin e ujërave të ndotura”, për miratimin e tarifave të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura.

- Dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria UK Vorë kishte pasaktësi sa i takon Seancës Dëgjimore me Publikun, pasi kjo e fundit nuk ishte zhvilluar konform udhëzuesit për organizimin e seancës dëgjimore ku të jenë prezent edhe përfaqësuesit e ERRU-së.

- ERRU-ja iu drejtua shoqërisë me shkresën nr. 328/1 prot., datë 23.7.2018 për plotësim të dokumentacionit të mësipërm. Shoqëria UK Vorë me shkresë nr. 1192 prot., datë 7.12.2018 ka njoftuar ERRU-në për zhvillimin e Seancës Dëgjimore me Publikun në datën 17.12.2018 pranë ambienteve të Bashkisë Vorë dhe me shkresën nr. 40 prot., datë 11.1.2019 ka dërguar procesverbalin e zhvillimit të saj.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë UK Vorë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në vendimin nr. 40 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Vorë për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura.

2. Drejtoria Tekniko-Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Vorë sh.a. dhe Bashkinë Vorë për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

VENDIM

Nr. 6, datë 1.2.2019

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË SHËRBIMIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE LARGIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA PËR SHOQËRINË UJËSJIJELLËS-KANALIZIME TROPOJË

Në mbështetje të neneve 13, 14, 21 dhe 22, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar (ligji nr. 8102), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 40, datë 9.12.2015 “Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 40), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 41, datë 9.12.2015 “Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 41), vendimit të Komisionit Kombëtar Rregullator nr. 42, datë 9.12.2015 “Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura” (vendimi nr. 42),

Komisioni Kombëtar Rregullator,

në mbledhjen e datës 1.2.2019 pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga Drejtoria Tekniko-Ekonomike dhe Drejtoria Juridike mbi kërkesën e Ujësjiellës-Kanalizime Tropojë sh.a., për miratimin e tarifave të shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura,

konstatoi se:

Shoqëria UK Tropojë është licencuar nga ERRU-ja, me vendimin e KKRR-së nr. 40, datë 1.6.2018, “Për licencimin e shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Tropojë”, pas përfundimit të riorganizimit sipas ndarjes së re territoriale, bazuar në pikën 3, të kreut II, të VKM-së nr. 63, datë 27.1.2016, “Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura”.

Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Tropojë ka aplikuar pranë ERRU-së, me shkresën nr. 119 prot., datë 19.12.2018, me lëndë “Kërkesë për nivel



të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm”, bazuar në vlerësimin e situatës ekonomike-financiare dhe nevojën për përmirësimin e saj pas riorganizimit sipas reformës administrativo-territoriale.

Shoqëria UK Tropojë plotësoi dosjen e aplikimit me shkresën nr. 7 prot., datë 10.1.2019, me të cilën përcolli dokumentin “Vendimi i Organit Drejtues për nivelin e ri të tarifave të kërkuara”.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator, pasi arriti në përfundimin se aplikimi i shoqërisë UK Tropojë është i bazuar ligjërisht dhe plotëson kërkesat ligjore të parashikuara në vendimin nr. 40 dhe kuadrin rregullator në fuqi,

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë Ujësjellës-Kanalizime Tropojë sh.a. për nivel të ri tarife për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura.

2. Drejtoria Tekniko-Ekonomike detyrohet të njoftojë shoqërinë Ujësjellës-Kanalizime Tropojë sh.a. dhe Bashkinë Tropojë për vendimin e Komisionit Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2019

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 224 lekë